



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.90

5 korrik

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 432 datë 16.6.2011	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen e rishikuar të Kombeve të Bashkuara, në lidhje me miratimin e parashikimeve teknike uniforme për automjetet me rrota, pajisjet dhe pjesët që mund të instalohen dhe/ose përdoren tek automjetet me rrota dhe kushtet për njohjen reciproke të aprovimeve të dhëna mbi bazën e këtyre parashikimeve” 3707
Ligj nr.10 433 datë 16.6.2011	Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë..... 3715
Vendim i Kuvendit nr.106, datë 23.6.2011	Për miratimin e propozimit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.24, datë 9.6.2011..... 3732
Vendim i Kuvendit nr.107, datë 23.6.2011	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Fatmir Hoxha anëtar i Gjykatës Kushtetuese..... 3732
Vendim i Kuvendit nr.108, datë 23.6.2011	Për emërimin e kryetarit të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) 3733
Rezolutë e Kuvendit datë 23.6.2011	Për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2010 3733
Dekret nr.7028 datë 27.6.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 3734
Vendim i KM nr.471, datë 2.7.2011	Për rritjen e pensioneve..... 3734
Vendim i GJK nr.28, datë 23.6.2011	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.00-2010-1233, datë 22.10.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. 3737

LIGJ
Nr.10 432, datë 16.6.2011

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN E RISHIKUAR TË KOMBEVE TË BASHKUARA, NË LIDHJE ME MIRATIMIN E PARASHIKIMEVE TEKNIKE UNIFORME PËR AUTOMJETET ME RROTA, PAJISJET DHE PJESËT QË MUND TË INSTALOHEN DHE/OSE PËRDOREN TEK AUTOMJETET ME RROTA DHE KUSHTET PËR NJOHJEN RECIPROKE TË APROVIMEVE TË DHËNA MBI BAZËN E KËTYRE PARASHIKIMEVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen e rishikuar të Kombeve të Bashkuara, në lidhje me miratimin e parashikimeve teknike uniforme për automjetet me rrota, pajisjet dhe pjesët që mund të instalohen dhe/ose përdoren tek automjetet me rrota dhe kushtet për njohjen reciproke të aprovimeve të dhëna mbi bazën e këtyre parashikimeve”, hyrë në fuqi më 16 tetor 1995.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7034, datë 29.6.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Bamir Topi

KOMISIONI EKONOMIK PËR EUROPËN
KOMITETI I TRANSPORTIT VENDAS

MARRËVESHJE

NË LIDHJE ME MIRATIMIN E PARASHIKIMEVE TEKNIKE UNIFORME PËR AUTOMJETET ME RROTA, PAJISJET DHE PJESËT QË MUND TË INSTALOHEN DHE/OSE PËRDOREN TEK AUTOMJETET ME RROTA DHE KUSHTET PËR NJOHJEN RECIPROKE TË APROVIMEVE TË DHËNA MBI BAZËN E KËTYRE PARASHIKIMEVE¹

Rishikimi 2

(Duke përfshirë ndryshimet që kanë hyrë në fuqi më 16 tetor 1995)

Kombet e Bashkuara

Preambul

Palët kontraktuese,

duke vendosur, ndryshimin e marrëveshjes në lidhje me kushteve uniforme të aprovimit dhe njohjes reciproke të aprovimit për automjetet motorike, pajisjet dhe pjesët, bërë në Gjenevë më 20 mars 1958; dhe

me dëshirën për të përkufizuar parashikimet teknike uniforme që do të jenë të mjaftueshme për t’u përmbushur nga automjete të caktuara me rrota, pajisje dhe pjesë për t’u përdorur në vendet e tyre;

me dëshirën për të miratuar këto parashikime kurdoherë e mundur në vendet e tyre; dhe

¹ Titulli i mëparshëm i Marrëveshjes: Marrëveshja në lidhje me kushteve uniforme të aprovimit dhe njohjes reciproke të aprovimit për automjetet motorike, pajisjet dhe pjesët, bërë në Gjenevë me 20 mars 1958.

me dëshirën për të lehtësuar përdorimin në vendet e tyre të automjeteve, pajisjeve dhe pjesëve, nëse aprovohen sipas këtyre parashikimeve nga autoritetet kompetente të një pale tjetër kontraktuese, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

1. Palët kontraktuese vendosin nëpërmjet një komiteti administrativ të përbërë nga të gjitha palët kontraktuese në pajtim me rregullat procedurale të caktuara në shtojcën 1 dhe mbi bazën e neneve dhe paragrafëve të mëposhtëm, rregulloret për automjetet me rrota, pajisjet dhe pjesët që mund të instalohen dhe/ose përdoren tek automjetet me rrota. Sipas nevojës, kërkesat teknike do të përfshijnë alternativa dhe nëse është e mundur ato do të jenë të orientuara nga rendimenti dhe përfshijnë metodat e testimit. Kushtet për dhënien e aprovimeve tipit dhe njohja e tyre reciproke do të përfshihet për përdorim nga palët kontraktuese që zgjedhin të zbatojnë rregulloret nëpërmjet aprovimit tipit.

Për qëllime të kësaj marrëveshjeje:

Termi “automjetet me rrota, pajisje dhe pjesë” përfshin çdo automjet me rrota, pajisje dhe pjesë, karakteristikat e të cilave kanë lidhje me sigurinë në rrugë, mbrojtjen e ambientit dhe kursimin e energjisë;

Termi “aprovim tipi në pajtim me një rregullore” tregon një procedurë administrative, nëpërmjet së cilës autoritetet kompetente të një pale kontraktuese deklarojnë, pas kryerjes së verifikimeve të nevojshme, që një automjet, pajisje ose pjesë e paraqitur nga një prodhues është në pajtim me kërkesat e rregullores përkatëse. Pas kësaj prodhuesi certifikon që çdo automjet, pajisje ose pjesë që hidhet në treg është prodhuar për të qenë identike me produktin e aprovuar.

Për zbatimin e rregulloreve mund të ketë procedura administrative të ndryshme alternative me aprovimin e tipit. E vetmja procedurë alternative përgjithësisht e njohur dhe e zbatuar në shtete të caktuara anëtare të komisionit ekonomik të Europës është vetëcertifikimi, nëpërmjet të cilit prodhuesi certifikon pa asnjë kontroll paraprak administrativ, që çdo produkt i hedhur në treg është në pajtim me rregulloren e dhënë. Autoritetet administrative kompetente mund të verifikojnë nëpërmjet vëzhgimit rastësor në treg që produktet e vetëcertifikuara përputhen me kërkesat e një rregulloreje të caktuar.

2. Komiteti administrativ mund të përbëhet nga të gjitha palët kontraktuese në pajtim me rregullat procedurale të përcaktuara në shtojcën 1. Një rregullore, pasi të jetë vendosur në pajtim me procedurën e treguar në shtojcën 1, i komunikohet nëpërmjet komitetit administrativ Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, që më poshtë quhet “Sekretar i Përgjithshëm”. Sapo të jetë e mundur pas kësaj, Sekretari i Përgjithshëm u bën njoftimin e kësaj rregulloreje palëve kontraktuese.

Rregullorja konsiderohet si e miratuar, përveç kur, brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga njoftimi i saj nga Sekretari i Përgjithshëm, më shumë se një e treta e palëve kontraktuese në momentin e njoftimit kanë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për mospajtimin e tyre me rregulloren.

Rregullorja mbulon sa më poshtë:

- a) automjetet me rrota, pajisjet dhe pjesët përkatëse;
- b) kërkesat teknike, që, sipas rastit, mund të përfshijnë alternativa;
- c) metodat e testimit, nëpërmjet të cilave duhet të demonstronhet çdo kërkesë rendimenti;
- d) kushtet për dhënien e aprovimit tipit dhe njohjen e tyre reciproke duke përfshirë çdo shënim dhe kusht aprovimi për të siguruar përputhshmërinë e prodhimit;
- e) datën(at) në të cilën hyn në fuqi rregullorja.

Rregullorja, nëse është e nevojshme, përfshin referencat te laboratorët e akredituar nga autoritetet kompetente ku duhet të kryhen testet e pranimit të llojeve të automjeteve me rrota, pajisjeve dhe pjesëve të paraqitura për aprovim.

3. Nëse një rregullore është miratuar, Sekretari i Përgjithshëm njofton gjithashtu sa më shpejt të jetë e mundur të gjitha palët kontraktuese, duke specifikuar cilat palë kontraktuese kanë kundërshtuar dhe në lidhje me të cilat nuk hyn në fuqi rregullorja.

4. Rregullorja e miratuar hyn në fuqi në datën(at) e specifikuar(a) në të si një rregullore bashkëngjitur kësaj marrëveshjeje për të gjitha palët kontraktuese që nuk kanë njoftuar mospajtimin e tyre.

5. Gjatë depozitimit të instrumentit të saj të aderimit, çdo palë e re kontraktuese mund të deklarojë që ajo nuk u nënshtrohet rregulloreve të caktuara që i janë bashkëngjitur deri atëherë kësaj marrëveshjeje ose që as nuk i nënshtrohet asnjërës prej tyre. Nëse, në atë kohë, procedura e parashikuar

në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni është në proces të një projekti ose rregulloreje të miratuar, Sekretari i Përgjithshëm i komunikon këtë projekt ose rregullore të miratuar palës së re kontraktuese dhe ajo hyn në fuqi si një rregullore për palën e re kontraktuese vetëm në kushtet e specifikuara në paragrafin 4 të këtij neni. Sekretari i Përgjithshëm njofton të gjitha palët kontraktuese për datën e hyrjes së saj në fuqi. Sekretari i Përgjithshëm u komunikon, gjithashtu, të gjitha deklaratat në lidhje me moszbatimin e rregulloreve të caktuara që mund të bëjë çdo palë kontraktuese në pajtim me termat e këtij paragrafi.

6. Çdo palë kontraktuese që zbaton një rregullore në çdo kohë mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm, brenda një afati njëvjeçar, që administrata e saj synon të pushojë zbatimin e saj. Një njoftim i tillë u komunikohet palëve kontraktuese nga Sekretari i Përgjithshëm.

Aprovimet e dhëna mbeten të vlefshme deri në tërheqjen e tyre.

Nëse një palë kontraktuese pushon së lëshuari aprovime sipas një rregulloreje, ajo:

- realizon mbikëqyrjen e duhur mbi përputhshmërinë e prodhimit të produkteve, për të cilat ka lëshuar më parë aprovimin e saj të tipit;
- merr të gjitha hapat e nevojshëm të përcaktuara në nenin 4 kur njoftohet për mospërputhshmëri nga një palë kontraktuese që vazhdon të zbatojë rregulloren;
- vazhdon të njoftojë autoritetet kompetente të palëve të tjera kontraktuese për tërheqjen e aprovimeve sipas parashikimit në nenin 5;
- vazhdon të miratojë zgjatjen e afatit të aprovimeve ekzistuese.

7. Çdo palë kontraktuese që nuk zbaton një rregullore mund të njoftojë në çdo kohë Sekretarin e Përgjithshëm se ajo synon që tani e tutje ta zbatojë atë dhe rregullorja hyn në fuqi për këtë palë në ditën e gjashtëdhjetë pas këtij njoftimi. Sekretari i Përgjithshëm njofton të gjitha palët kontraktuese për çdo hyrje në fuqi të një rregulloreje për një palë të re kontraktuese të kryer në pajtim me termat e këtij paragrafi.

8. Palët kontraktuese, për të cilat është në fuqi një rregullore, quhen në vijim “palët kontraktuese që zbatojnë një rregullore”.

Neni 2

Secila palë kontraktuese që zbaton rregulloret gjerësisht nëpërmjet aprovimit të tipit jep aprovimet e tipit dhe shenjat e aprovimit të përshkruara në çdo rregullore për llojet e automjeteve me rrota, pajisjet ose pjesët e mbuluara nga rregullorja, me kusht që ajo të ketë kompetencën teknike dhe të jetë e kënaqur me masat për të siguruar përputhshmërinë e produktit me tipin e aprovuar sipas përcaktimit në shtojcën 2. Secila palë kontraktuese që zbaton një rregullore nëpërmjet një aprovimi tipi refuzon aprovimet e tipit dhe shenjat e aprovimit të mbuluara nga rregullorja, nëse nuk përmbushen kushtet e përmendur më sipër.

Neni 3

Automjetet me rrota, pajisjet ose pjesët për të cilat janë dhënë aprovimet e tipit nga një palë kontraktuese në pajtim me nenin 2 të kësaj marrëveshjeje dhe të prodhuara qoftë në territorin e një palë kontraktuese që zbaton rregulloren përkatëse, ose në një vend tjetër që përcaktohet nga pala kontraktuese që ka aprovuar rregullisht llojet e automjeteve me rrota, pajisjeve ose pjesëve përkatëse konsiderohen të jenë në pajtim me legjislacionin e të gjitha palëve kontraktuese që zbatojnë këto rregullore nëpërmjet aprovimit të tipit.

Neni 4

Nëse autoritetet kompetente të një pale kontraktuese që zbatojnë një rregullore nëpërmjet aprovimit të tipit, konstatojnë që disa automjete me rrota, pajisje ose pjesë që kanë shenja aprovimi të lëshuara sipas kësaj rregulloreje nga një prej palëve kontraktuese, nuk përputhen me llojet e aprovuara, ato vënë në dijeni autoritetet kompetente të palës kontraktuese që ka lëshuar aprovimin. Ajo palë kontraktuese merr hapat e nevojshëm për t'i bërë produktet e atyre prodhuesve të pajtueshme me llojet e aprovuara(a) dhe njofton palët e tjera kontraktuese që zbatojnë rregulloren nëpërmjet aprovimit të tipit në lidhje me hapat që ka ndërmarrë, të cilat mund të përfshijnë, sipas rastit, tërheqjen e aprovimit. Nëse mund të ketë një rrezik për sigurinë në rrugë ose ambientin, pala kontraktuese që ka lëshuar aprovimin dhe pas marrjes së informacionit në lidhje me mospërputhshmërinë e tipit(ave) të aprovuar(a), njofton për këtë të gjitha palët kontraktuese në lidhje me këtë situatë. Palët kontraktuese mund të ndalojnë shitjen dhe përdorimin e këtyre automjeteve me rrota, pajisjeve ose pjesëve në territorin e tyre.

Neni 5

Autoritetet kompetente të secilës palë kontraktuese, që zbatojnë rregulloret nëpërmjet aprovimit të tipit u dërgojnë çdo muaj autoriteteve kompetente të palëve të tjera kontraktuese një listë të automjeteve me rrota, pajisjeve ose pjesëve, aprovimet e të cilave ajo ka refuzuar t'i japë ose i ka tërhequr gjatë atij muaji; përveç kësaj, me marrjen e një kërkesë nga autoriteti kompetent i një pale tjetër kontraktuese që zbaton një rregullore nëpërmjet aprovimit tipit, ajo i dërgon menjëherë atij autoriteti kompetent një kopje të të gjithë informacionit përkatës, mbi të cilin ajo ka bazuar vendimin e saj për dhënien, refuzimin ose tërheqjen e një aprovimi për një automjet me rrota, pajisje ose pjesë sipas asaj rregulloreje.

Neni 6

1. Vendet anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën, vendet e pranura në komision në një cilësi konsultative në pajtim me paragrafin 8 të termave të referencës së komisionit, organizatat rajonale të integritit ekonomik të krijuara nga vendet anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën, të cilave shtetet e tyre anëtare u kanë transferuar kompetencat në fushat e mbuluara nga kjo marrëveshje, duke përfshirë kompetencën për të marrë vendime detyruese për shtetet e tyre anëtare, mund të bëhen palë kontraktuese në këtë marrëveshje.

Për përcaktimin e numrit të votave të përmendura në nenin 1, paragrafi 2 dhe në nenin 12, paragrafi 2, organizatat rajonale të integritit ekonomik votojnë me numrin e votave të shteteve të tyre anëtare që janë anëtarë të Komisionit Ekonomik për Europën.

2. Vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara që mund të marrin pjesë në aktivitete të caktuara të Komisionit Ekonomik për Europën në pajtim me paragrafin 11 të termave të referencës së Komisionit dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik të këtyre vendeve, të cilave shtetet anëtare të tyre u kanë transferuar kompetencat në fushat e mbuluara nga kjo marrëveshje, duke përfshirë kompetencën të marrin vendime detyruese për shtetet anëtare të tyre, mund të bëhen palë kontraktuese në këtë marrëveshje. Për përcaktimin e numrit të votave të përmendura në nenin 1, paragrafi 2 dhe në nenin 12, paragrafi 2, organizatat rajonale të integritit ekonomik votojnë me numrin e votave të shteteve anëtare të tyre që janë anëtarë të Kombeve të Bashkuara.

3. Aderimi në marrëveshjen e ndryshuar nga palët e reja kontraktuese që nuk janë palë në marrëveshjen e vitit 1958 realizohet nëpërmjet depozitimit të një instrumenti te sekretari i përgjithshëm, pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së ndryshuar.

Neni 7

1. Marrëveshja e ndryshuar konsiderohet të hyjë në fuqi nëntë muaj pas datës së transmetimit të saj nga Sekretari i Përgjithshëm të të gjithë palët kontraktuese të marrëveshjes së vitit 1958.

2. Marrëveshja e ndryshuar konsiderohet të mos hyjë në fuqi nëse shprehet një kundërshtim nga palët kontraktuese të marrëveshjes së vitit 1958 brenda një periudhe prej gjashtë muajsh pas datës së transmetimit të saj tek ata nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Për çdo palë kontraktuese të re që aderon në këtë marrëveshje të ndryshuar, kjo marrëveshje e ndryshuar hyn në fuqi në ditën e gjashtëdhjetë pas depozitimit të instrumentit të aderimit.

Neni 8

1. Çdo palë kontraktuese mund të denoncojë këtë marrëveshje nëpërmjet njoftimit të Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Denoncimi hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 9

1. Çdo palë kontraktuese e re sipas përkufizimit në nenin 6 të kësaj marrëveshjeje, në momentin e aderimit ose në çdo moment pas këtij, mund të deklarojë nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të

Përgjithshëm që kjo marrëveshje do të shtrihet te të gjitha ose ndonjë prej territoreve për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve është përgjegjës. Marrëveshja shtrihet në territorin ose territoret e përmendura në njoftim që nga dita e gjashtëdhjetë e marrjes së saj nga Sekretari i Përgjithshëm.

2. Çdo palë kontraktuese e re sipas përkufizimit në nenin 6 të kësaj marrëveshjeje, që ka bërë një deklaratë në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni që e shtrin këtë marrëveshje te çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve është përgjegjëse mund ta denoncojë këtë marrëveshje veçmas në lidhje me atë territor, në pajtim me dispozitat e nenit 8.

Neni 10

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje, për sa është e mundur, zgjidhet me bisedime ndërmjet tyre.

2. Çdo mosmarrëveshje që nuk është zgjidhur me bisedime paraqitet në arbitrazh nëse një prej palëve kontraktuese në mosmarrëveshje e kërkon këtë dhe i paraqitet përkatësisht një ose më shumë arbitrave të zgjedhur me marrëveshje ndërmjet palëve në mosmarrëveshje. Nëse brenda tre muajve nga data e kërkesës për arbitrazh palët në mosmarrëveshje nuk janë në gjendje të bien dakord mbi zgjedhjen e një arbitri ose arbitrave, secila prej këtyre palëve mund t'i kërkojë Sekretarit të Përgjithshëm të caktojë një arbitër të vetëm të cilit i paraqitet mosmarrëveshja për vendim.

3. Vendimi i arbitrit ose arbitrave të emëruar në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, është detyrues për palët kontraktuese në mosmarrëveshje.

Neni 11

1. Çdo palë kontraktuese e re, në momentin e aderimit në këtë marrëveshje, mund të deklarojë që ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga neni 10 i marrëveshjes. Palët e tjera kontraktuese nuk janë të detyruara nga neni 10 në lidhje me çdo palë kontraktuese të re që ka bërë një rezervë të tillë.

2. Çdo palë kontraktuese që ka bërë një rezervë sipas parashikimit në paragrafin 1 të këtij neni në çdo kohë mund ta tërheqë këtë rezervë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm.

3. Asnjë rezervë tjetër për këtë marrëveshje ose rregulloret e bashkëngjitura asaj nuk lejohet; por çdo palë kontraktuese, në pajtim me termat e nenit 1, mund të deklarojë që ajo nuk ka si qëllim të zbatojë ndonjë prej rregulloreve ose që nuk ka qëllim të zbatojë ndonjë prej tyre.

Neni 12

Rregulloret e bashkëngjitura kësaj marrëveshjeje mund të ndryshohen në pajtim me procedurën e mëposhtme:

1. Ndryshimet në rregullore vendosen nga Komiteti Administrativ sipas përshkrimit në nenin 1, paragrafin 2, dhe në pajtim me procedurën e treguar në shtojcën 1. Sipas rastit një ndryshim mund të përfshijë kërkesat ekzistuese si një alternativë. Palët kontraktuese specifikojnë cilat alternativa brenda rregulloreve do të zbatojnë. Palët kontraktuese që zbatojnë alternativa brenda një rregulloreje nuk janë të detyruara të pranojnë aprovimet e alternativave të mëparshme në të njëjtën rregullore. Palët kontraktuese që zbatojnë vetëm ndryshimet më të fundit nuk janë të detyruara të pranojnë aprovimet e ndryshimeve të mëparshme ose rregulloreve të pandryshuara. Palët kontraktuese që zbatojnë një seri të mëparshme të ndryshimeve ose rregullores së pandryshuara pranojnë aprovimet e dhëna për një seri të mëvonshme ndryshimesh. Një ndryshim për rregulloren, pasi të jetë vendosur, i komunikohet nga Komiteti Administrativ Sekretarit të Përgjithshëm. Sa më shpejt të jetë e mundur pas kësaj, Sekretari i Përgjithshëm u bën njoftim për këtë ndryshim palëve kontraktuese që zbatojnë rregulloren.

2. Një ndryshim te një rregullore konsiderohet të jetë miratuar përveç kur, brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga njoftimi i saj nga Sekretari i Përgjithshëm, më shumë se një e treta e palëve kontraktuese që zbatojnë rregulloren në momentin e njoftimit kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm për mospajtimin e tyre për ndryshimin. Nëse pas këtij afati, Sekretari i Përgjithshëm nuk ka marrë deklaratimet e mospajtimeve nga më shumë se një e treta e palëve kontraktuese që zbatojnë rregulloren, Sekretari i Përgjithshëm sa më shpejt të jetë e mundur, deklaron ndryshimin si të miratuar dhe detyrues për ato palë kontraktuese që zbatojnë rregulloren që nuk janë deklaruar kundër saj. Nëse një rregullore

ndryshohet dhe të paktën një e pesta e palëve kontraktuese që zbatojnë rregulloren e pandryshuar deklarohen më vonë se ata dëshirojnë të vazhdojnë të zbatojnë rregulloren e pandryshuar, rregullorja e pandryshuar do të konsiderohet si një alternativë për rregulloren e ndryshuar dhe përfshihet zyrtarisht si e tillë në rregulloren me fuqi nga data e miratimit të këtij ndryshimi ose të hyrjes së saj në fuqi. Në këtë rast, detyrimet e palëve kontraktuese që zbatojnë rregulloren janë të njëjta si ato të parashikuara në paragrafin 1.

3. Nëse një palë kontraktuese e re aderon në këtë marrëveshje ndërmjet kohës së njoftimit të ndryshimit të një rregulloreje nga Sekretari i Përgjithshëm dhe hyrjes së saj në fuqi, rregullorja në fjalë nuk hyn në fuqi për atë palë kontraktuese dy muaj pasi ajo të ketë pranuar formalisht ndryshimin ose dy muaj pas kalimit të një afati prej gjashtë muajsh që nga komunikimi i ndryshimit të propozuar për atë palë nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 13

Teksti i vetë marrëveshjes dhe i shtojcave i saj mund të ndryshohen në pajtim me procedurën e mëposhtme:

1. Çdo palë kontraktuese mund të propozojë një ose më shumë ndryshime të kësaj marrëveshjeje dhe të shtojcave të saj. Teksti i çdo ndryshimi të propozuar të marrëveshjes dhe shtojcave të saj i transmetohet Sekretarit të Përgjithshëm, që ua transmeton atë të gjitha palëve kontraktuese dhe informon të gjithë vendet e tjera të përmendura në paragrafin 1 të nenit 6 të saj.

2. Çdo ndryshim i propozuar i qarkulluar në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, konsiderohet të pranohet nëse asnjë palë kontraktuese nuk shpreh kundërshtimin e saj brenda një periudhe prej gjashtë muajsh pas datës së qarkullimit të ndryshimit të propozuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Sekretari i Përgjithshëm, sa më parë të jetë e mundur, njofton të gjitha palët kontraktuese nëse është shprehur një kundërshtim për ndryshimin e propozuar. Nëse është shprehur një kundërshtim për ndryshimin e propozuar, ky ndryshim konsiderohet sikur nuk është pranuar dhe nuk ka asnjë lloj efekti. Nëse nuk është shprehur asnjë kundërshtim, ndryshimi hyn në fuqi për të gjitha palët kontraktuese tre muaj pas skadimit të afatit prej gjashtë muajsh të përmendur në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 14

Përveç njoftimeve të parashikuara në nenet 1, 12 dhe 13 të kësaj marrëveshjeje, Sekretari i Përgjithshëm njofton palët kontraktuese për:

- a) aderimet në pajtim me nenin 6;
- b) datat e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje në pajtim me nenin 7;
- c) denoncimet në pajtim me nenin 8;
- d) njoftimet e marra në pajtim me nenin 9;
- e) deklaratimet dhe njoftimet e marra në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 11;
- f) hyrjen në fuqi të çdo ndryshimi në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 12;
- g) hyrjen në fuqi të çdo ndryshimi në pajtim me paragrafin 3 të nenit 13.

Neni 15

1. Nëse në datën që dispozitat e mësipërme hyjnë në fuqi po kryhen procedurat e parashikuara në nenin 1, paragrafët 3 dhe 4 të marrëveshjes së pandryshuar për të miratuar një rregullore të re, kjo rregullore e re hyn në fuqi sipas dispozitave të paragrafit 5 të këtij neni.

2. Nëse në datën që dispozitat e mësipërme hyjnë në fuqi po kryhen procedurat e parashikuara në nenin 12, paragrafi 1 të marrëveshjes së pandryshuar për miratimin e një ndryshimi të një rregulloreje, ky ndryshim hyn në fuqi sipas dispozitave të këtij neni.

3. Nëse të gjitha palët kontraktuese të marrëveshjes bien dakord, çdo rregullore e miratuar sipas termave të marrëveshjes së pandryshuar mund të trajtohet sikur të ishte një rregullore e miratuar sipas termave të dispozitave të mësipërme.

SHTOJCA 1
PËRBËRJA DHE RREGULLAT PROCEDURALE TË KOMITETIT ADMINISTRATIV

Neni 1

Anëtarët e Komitetit Administrativ përbëhen nga të gjitha palët kontraktuese të marrëveshjes së ndryshuar.

Neni 2

Sekretari Ekzekutiv i Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën i siguron Komitetit shërbimet e sekretarisë.

Neni 3

Komiteti në sesionin e parë të çdo viti zgjedh një kryetar dhe një zëvendëskryetar.

Neni 4

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara mbledh Komitetin nën kujdesin e Komisionit Ekonomik për Europën kurdoherë që kërkohet të vendoset një rregullore e re ose një ndryshim të një rregullore e re.

Neni 5

Rregulloret e reja të propozuara hidhen në votim. Secili vend, palë kontraktuese në këtë marrëveshje, ka një votë. Një kuorum prej jo më pak se gjysma e palëve kontraktuese kërkohet për qëllimet e marrjes së vendimeve. Për përcaktimin e kuorumit, organizatat rajonale të integritit ekonomik që janë palë kontraktuese në marrëveshje votojnë me numrin e votave të shteteve anëtare të tyre. Përfaqësuesi i një organizate rajonale të integritit ekonomik mund të japë votat e vendeve sovraane përbërëse të tij. Projektregulloret e reja vendosen me një shumicë prej dy të tretat të atyre që janë të pranishëm dhe që votojnë.

Neni 6

Ndryshimet e propozuara të marrëveshjes hidhen në votim. Secili vend, palë përfaqësuese në marrëveshje që zbaton rregulloren, ka një votë. Një kuorum prej jo më pak se gjysma e palëve kontraktuese që zbatojnë rregulloren kërkohet për qëllimet e marrjes së vendimeve. Për përcaktimin e kuorumit organizatat rajonale të integritit ekonomik që janë palë kontraktuese në marrëveshje votojnë me numrin e votave të shteteve anëtare të tyre. Përfaqësuesi i një organizate rajonale të integritit ekonomik mund të japë votat e vendeve sovraane përbërës të tij që zbatojnë rregulloren. Projektndryshimet e rregullores vendosen me një shumicë prej dy të tretat të atyre që janë të pranishëm dhe që votojnë.

SHTOJCA 2
PËRPUTHSHMËRIA ME PROCEDURAT E PRODHIMIT

1. Vlerësimi fillestar

1.1 Autoriteti aprovues i një pale kontraktuese duhet të verifikojë para dhënies së aprovimit të tipit ekzistencën e masave dhe procedurave të pranueshme për të siguruar kontrollin efektiv të atij automjeti, pajisjeje ose pjesëve në prodhim përputhen me tipin e aprovuar.

1.2 Kërkesa e paragrafit 1.1 duhet të verifikohet sipas bindjes së autoritetit që jep aprovimin e tipit, por gjithashtu, në emër dhe me kërkesë të autoritetit që jep aprovimin e tipit, mund të verifikohet nga autoriteti aprovues i një pale tjetër kontraktuese. Në këtë rast, autoriteti i fundit aprovues përgatit një deklaratë të përputhshmërisë, duke përcaktuar fushat dhe pajisjet e prodhimit që ka mbuluar si të rëndësishme për produktin(et) që duhet të marrin aprovimin e tipit(ave).

1.3 Autoriteti aprovues duhet të pranojë gjithashtu regjistrimin e prodhuesit sipas standardit të harmonizuar ISO 9002 (objekti i të cilit mbulon produktin(et) që duhet të aprovohet) ose një standard ekuivalent akreditimi që përmbush kërkesat e paragrafit 1.1. Prodhuesi duhet të japë hollësi për regjistrimin dhe të ndërmarrë të informojë autoritetin aprovues për çdo rishikim për vlefshmërinë ose objektin e tij.

1.4 Me marrjen e një kërkesë nga autoriteti i një pale tjetër kontraktuese, autoriteti aprovues dërgon menjëherë deklarin e përputhshmërisë së përmendur në fjalinë e fundit të paragrafit 1.2 ose njofton që nuk është në gjendje të bëjë një deklaratë të tillë.

2. Përputhshmëria e prodhimit

2.1 Çdo automjet, pajisje ose pjesë e aprovuar sipas rregullores së bashkëngjitur kësaj marrëveshjeje duhet të prodhohet në mënyrë të tillë që të përputhet me tipin e aprovuar, duke përmbushur kërkesat e kësaj shtojce dhe të rregullores përkatëse.

2.2 Autoriteti aprovues i një pale kontraktuese që jep aprovimin e tipit në pajtim me një rregullore bashkëngjitur kësaj marrëveshjeje duhet të verifikojë ekzistencën e masave të përshtatshme dhe planeve të dokumentuara të kontrollit, që përcaktohen së bashku me prodhuesin për çdo aprovim, për të kryer në intervale të përcaktuara ato teste dhe kontrole përkatëse që janë të nevojshme për të verifikuar përputhshmërinë e vazhduar me tipin e aprovuar, duke përfshirë, sipas rastit, testet e përcaktuara në rregulloren përkatëse.

2.3 Titullari i aprovimit duhet që, veçanërisht:

2.3.1 të sigurojë ekzistencën e procedurave për kontrollin efektiv të përputhshmërisë të produkteve (automjetet, pajisjet ose pjesët) me aprovimin e tipit;

2.3.2 të ketë mundësi për pajisjet e testimit të nevojshme për kontrollimin e përputhshmërisë me çdo tip të aprovuar;

2.3.3 të sigurojë që të dhënat për rezultatet e testeve të regjistruhen dhe që dokumentet e bashkëngjitura të mbeten të disponueshme për një afat që duhet të caktohet në marrëveshje me autoritetin aprovues. Ky afat nuk duhet të jetë më shumë se 10 vjet;

2.3.4 të analizojë rezultatet për çdo tip testi, me qëllim që të verifikohet dhe sigurohet stabiliteti i karakteristikave të produktit, duke lënë tolerancë për devijimet e një produkti industrial;

2.3.5 të sigurojë që për çdo tip produkti të kryhen të paktën kontrollet e parashikuara në këtë shtojcë dhe testet e parashikuara në rregulloret e zbatueshme;

2.3.6 të sigurojë që çdo grup ekzemplarësh ose pjesë testi që përbëjnë provë për mospërputhjen me tipin e testit në fjalë të bëhet shkak për një zgjedhje tjetër ekzemplarësh dhe testimi. Duhet të merren të gjithë hapat e nevojshëm për të rivendosur përputhshmërinë e prodhimit përkatës.

2.4 Autoriteti që ka dhënë aprovimin e tipit në çdo kohë mund të verifikojë metodat e kontrollit të përputhshmërisë të zbatuara në çdo repart prodhimi. Frekuenca normale e këtyre verifikimeve duhet të jetë në pajtim me masat (sipas rastit) e pranuar sipas paragrafit 1.2 ose 1.3 të kësaj shtojce dhe të jenë të tilla që të sigurojnë se janë rishikuar të gjitha kontrollet përkatëse gjatë një afati në pajtim me klimën e besimit të vendosur nga autoriteti i aprovimit.

2.4.1 Në çdo inspektim, regjistrat e testeve dhe regjistrat e prodhimit duhet të jenë të disponueshëm për inspektorin kontrollues.

2.4.2 Nëse natyra e testit është e përshtatshme, inspektori mund të zgjedhë ekzemplarë rastësorë për t'u testuar në laboratorin e prodhuesit (ose nga shërbimi teknik nëse rregullorja e bashkëngjitur kësaj marrëveshjeje e parashikon këtë). Numri minimal i ekzemplarëve mund të përcaktohet në pajtim me rezultatet e verifikimit të vetë prodhuesit.

2.4.3 Nëse niveli i kontrollit duket i papranueshëm, ose nëse duket e nevojshme të verifikohet vlefshmëria e testeve të kryera në zbatim të paragrafit 2.4.2, inspektori mund të zgjedhë ekzemplarë për t'u dërguar shërbimit teknik që kryen testet e aprovimit të tipit.

2.4.4 Autoriteti aprovues mund të kryejë çdo kontroll ose test të parashikuar në këtë shtojcë ose në rregulloren e zbatueshme bashkëngjitur kësaj marrëveshjeje.

2.4.5 Në rastet kur gjatë një inspektimi konstatohen rezultate të papranueshme, autoriteti aprovues duhet të sigurojë që të ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm për të rivendosur përputhshmërinë e prodhimit sa më shpejt të jetë e mundur.

LIGJ
Nr.10 433, datë 16.6.2011

PËR INSPEKTIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton parimet e përgjithshme të inspektimit, organizimin e institucioneve publike, që kryejnë funksione inspektimi, statusin e inspektorëve, rregullat e procedimit administrativ të inspektimit dhe krijimin e funksionet e Inspektoratit Qendror.

Neni 2

Fusha e veprimit

1. Ky ligj është i zbatueshëm për funksionet e inspektimit në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore dhe të njësive të qeverisjes vendore, përveç:

- a) inspektimit të brendshëm me karakter administrativ në sektorin publik;
- b) auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe inspektimit financiar publik;
- c) kontrollit tatimor dhe atij doganor;
- ç) inspektimit të autoritetit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- d) inspektimit të lojërave të fatit.

2. Dispozitat e këtij ligji plotësohen me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Kërkesat ligjore” janë kërkesat e përcaktuara nga një ligj, akt nënligjor apo një leje, licencë a autorizim dhe që janë të detyrueshme për t’u respektuar gjatë ushtrimit të një veprimtarie të natyrës tregtare, ekonomike apo profesionale, përfshirë ato kërkesa të detyrueshme për t’u respektuar nga organet publike që ofrojnë shërbime publike.

2. “Subjekti i inspektimit” është çdo person fizik apo juridik, privat apo publik, që ka, sipas ligjit, detyrimin të respektojë një kërkesë ligjore.

3. “Inspektim” është çdo formë kontrolli që organi publik kryen për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.

4. “Inspektim rastësor” është ajo formë inspektimi, në të cilin subjekti i inspektimit është i përcaktueshëm, në mënyrë rastësore në bazë të veprimtarisë së caktuar që kryen apo në bazë të marrëdhënies me një ngjarje të përcaktuar, përfshirë kalimin në një periudhë të përcaktuar në një rrugë publike, ku ushtrohet inspektimi, apo ushtrimi i veprimtarisë në një zonë gjeografike a një treg të caktuar.

5. “Inspektim i programuar” është inspektimi që kryhet në bazë të programit të miratuar të inspektimit për çdo inspektorat qendror apo vendor.

6. “Inspektimi në vend” është inspektimi që kryhet në vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit të inspektimit.

7. “Inspektorati shtetëror” është institucioni qendror i ngarkuar me një apo disa funksione inspektimi në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore.

8. “Inspektorati vendor” është njësi organizative e njësisë së qeverisjes vendore, ngarkuar me një apo disa funksione inspektimi në juridiksionin e njësisë së qeverisjes vendore.

9. “Ministri përgjegjës” është ministri që mbulon fushën shtetërore të veprimtarisë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për një funksion të caktuar inspektimi.

10. “Dënim administrativ” është masa e paralajmërimit, gjoja dhe çdo masë apo sanksion tjetër administrativ, pavarësisht nga emri i parashikuar nga ligji që rregullon një funksion inspektimi.

11. “Paralajmërimi” është dënimi administrativ që sanksionon shkeljet e një rëndësie të vogël të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit dhe që ka për qëllim evidentimin e tyre dhe paralajmërimin e subjektit që, në rast përsëritjeje të së njëjtës shkelje apo shkeljeve të tjera, jepet një dënim administrativ më i rëndë.

KREU II QËLLIMI DHE PARIMET E INSPEKTIMIT

Neni 4 Qëllimi i inspektimit

1. Inspektimi ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe të interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë.

2. Qëllimi i veprimtarisë së inspektimit arrihet nëpërmjet:

- a) vlerësimit të respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit;
- b) dokumentimit të praktikave të mira në respektimin e kërkesave ligjore dhe përhapjen e tyre;
- c) këshillimit të subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore;
- ç) urdhërimit të korigjimit të shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimit të pasojave që rrjedhin prej tyre;

d) dhënies së dënimeve dhe marrjes së masave të tjera administrative për shmangien e rreziqeve që mund t’u shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë, të parashikuar nga ky ligj apo legjislacioni i posaçëm.

Neni 5 Parimi i pavarësisë së inspektimit

Inspektori apo grupi i inspektimit, brenda kompetencave të dhëna me ligj apo akt nënligjor, është plotësisht i pavarur në kryerjen e procedimit të inspektimit dhe marrjen e vendimeve për një rast konkret.

Neni 6 Parimi i proporcionalitetit në veprimtarinë e inspektimit

1. Në kryerjen e inspektimit, inspektori kryen veprimet e inspektimit në mënyrë të tillë që të ndërhyjë në veprimtarinë e subjektit të inspektimit vetëm për atë që është e domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të inspektimit.

2. Në përcaktimin e dënimit apo të masës që duhet marrë, inspektori, në përputhje me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara apo pasojave të tyre, vendos atë sanksion apo merr atë masë që është domosdoshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit të dënimit apo masës dhe që cenon më pak të drejtat apo interesat e ligjshëm të subjektit të inspektimit.

3. Në përcaktimin e një afati për korigjimin e shkeljeve të konstatuara dhe eliminimin e pasojave të tyre nga subjekti i inspektimit, inspektori merr në konsideratë rëndësinë e shkeljes, pasojat e saj dhe rrethanat konkrete që përcaktojnë kohën e nevojshme për kryerjen e veprimeve për këtë qëllim, me përpjekjet maksimale nga ana e subjektit të inspektimit.

Neni 7

Parimi i programimit të inspektimeve

Një subjekt mund të inspektohet vetëm në zbatim të programit të inspektimit. Përrjashtimisht, një subjekt mund të inspektohet jashtë programit në rastet e parashikuara shprehimisht me ligj.

Neni 8

Parimi i dispozitës më të favorshme ligjore

1. Kur dispozitat ligjore, në bazë të të cilave vepron inspektimi, janë të paqarta apo bien në kundërshtim me njëra-tjetrën, inspektori vepron në mënyrën që cenon më pak subjektin e inspektimit.

2. Kur subjekti i inspektimit ka vepruar në përputhje me një kërkesë ligjore që bie në kundërshtim me një kërkesë tjetër ligjore, veprimi i tij nuk do të konsiderohet në shkelje të ligjit.

Neni 9

Parimi i informimit të publikut dhe mbrojtjes së konfidencialitetit

1. Inspektorati informon publikun për konstatimet dhe masat e marra gjatë procedimit administrativ të inspektimit, nëse kjo është e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave fizikë e juridikë.

2. Informimi, sipas parimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, bëhet në bazë dhe brenda kufijve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale të subjektit të inspektimit apo personave të tjerë.

KREU III

ORGANIZMI DHE FUNKSIONIMI I INSPEKTORATEVE NË NIVEL QENDROR DHE VENDOR

Seksioni 1

Organizimi dhe funksionimi i inspektorateve shtetërore

Neni 10

Inspektoratet shtetërore

1. Funksionet e inspektimit në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore kryhen nga inspektoratet shtetërore, që janë institucione qendrore publike, në varësinë e një ministri përgjegjës. Si rregull, një inspektorat shtetëror është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën shtetërore të veprimtarisë së një ministrie.

2. Përrjashtimisht, një inspektorat shtetëror mund të jetë pjesë përbërëse e një institucioni tjetër, në varësi të një ministrie, nëse parashikohet shprehimisht nga një ligj i posaçëm.

3. Inspektorati shtetëror ushtron juridiksionin e tij territorial në të gjithë territorin e vendit. Nëse është e nevojshme, inspektorati mund të organizohet edhe në degë territoriale, të cilat drejtohen nga drejtuesi i degës përkatëse.

Neni 11

Krijimi dhe organizimi i inspektorateve shtetërore

1. Inspektorati shtetëror kompetent për kryerjen e një funksioni inspektimi të parashikuar me ligj krijohet apo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Këshilli i Ministrave përcakton varësinë institucionale, rregullat e organizimit e të funksionimit të inspektoratit shtetëror, funksionet e inspektimit në kompetencë të tij, si dhe numrin dhe juridiksionin territorial të degëve të tij, nëse ka të tilla.

3. Struktura dhe organika e inspektorateve shtetërore miratohet nga Kryeministri.

Neni 12

Drejtimi i inspektorateve shtetërore

1. Çdo inspektorat shtetëror drejtohet nga kryeinspektori. Kur inspektorati është pjesë përbërëse e një organi varësie, siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 10 të këtij ligji, kryeinspektor është vetë titullari i organit të varësisë.

2. Kryeinspektori dhe titullari i organit të varësisë, në rastin e parashikuar në pikën 2 të nenit 10 të këtij ligji, emërohet dhe lirohet nga detyra nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës.

3. Kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën dhe lirimin nga detyra të kryeinspektorit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Përgjegjësitë e kryeinspektorit

1. Kryeinspektori drejton veprimtarinë e inspektoratit dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.

2. Kryeinspektori është përgjegjës për organizimin e koordinimin e funksionimit, si dhe për cilësinë e efektivitetin e veprimtarisë së inspektoratit.

Seksioni 2

Inspektoratet në juridiksionin e njësisë të qeverisjes vendore

Neni 14

Krijimi i inspektorateve në juridiksionin e njësisë të qeverisjes vendore

1. Njësia, që kryen funksionin e inspektimit të parashikuar me ligj, në juridiksionin e njësisë së qeverisjes vendore, krijohet apo përcaktohet me vendim të këshillit të njësisë vendore përkatëse, sipas legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

2. Njësia e inspektimit, më poshtë “inspektorati vendor”, drejtohet nga kryeinspektori vendor.

3. Neni 13 i këtij ligji zbatohet edhe për kryeinspektorin vendor.

Seksioni 3

Inspektorati Qendror

Neni 15

Krijimi i Inspektoratit Qendror

1. Inspektorati Qendror krijohet si një institucion publik qendror, me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrit dhe financohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Rregullat e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Qendror miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Struktura dhe organika e Inspektoratit Qendror miratohet nga Kryeministri.

Neni 16

Misioni dhe funksionet e Inspektoratit Qendror

1. Inspektorati Qendror ka për mision përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

2. Inspektorati Qendror ka këto funksione:

a) bashkërendon dhe mbështet veprimtarinë e inspektorateve shtetërore e të inspektorateve vendore;

b) jep mendim këshillimor për programet e inspektimit, të hartuara nga inspektoratet shtetërore;

c) miraton rregulla të përgjithshme, bazë, për metodologjinë e vlerësimit të riskut, programimin e inspektimeve, dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit, si dhe raportimin e veprimtarisë së inspektorateve;

ç) miraton rregulla të përgjithshme për treguesit e përgjithshëm të efektivitetit dhe të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, si dhe kriteret e vlerësimit të tyre;

d) jep mendime për çdo nismë ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimit;

dh) mbikëqyr zbatimin e këtij ligji e të ligjit të posaçëm nga inspektorët shtetërorë, për programimin, autorizimin dhe kryerjen e procedimit të inspektimit, dhe ka të drejtë të propozojë marrjen e masave disiplinore ndaj inspektorëve dhe Kryeinspektorit Shtetëror, në rast të konstatimit të shkeljeve prej këtyre të fundit;

e) përgatit raportin vjetor të përgjithshëm të inspektimeve dhe ia paraqet për njohje Këshillit të Ministrave;

ë) bashkërendon veprimtarinë e trajnimit e të kualifikimit të inspektorëve;

f) miraton kërkesat specifike për arsimimin e inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore;

g) kryen testimin fillestar dhe periodik të inspektorëve;

gj) krijon dhe mban një *portal* unik të inspektimit, që shërben për programimin dhe bashkërendimin e inspektimeve, shkëmbimin e të dhënave ndërmjet inspektorateve të ndryshme, si dhe për informimin e publikut;

h) mban listën e përditësuar të inspektorëve në detyrë për çdo inspektorat shtetëror dhe vendor dhe e publikon atë në faqen zyrtare të internetit.

3. Kur nga Inspektorati Qendror propozohet një masë disiplinore ndaj një inspektori apo kryeinspektori shtetëror, sipas shkronjës “dh” të pikës 2 të këtij neni, kryeinspektori apo përkatësisht eprori i drejtpërdrejtë i kryeinspektorit detyrohet të fillojë, pa vonesë, procedimin disiplinor.

4. Për realizimin e funksioneve të tij, Inspektorati Qendror ka të drejtë të kërkojë të gjithë informacionin e nevojshëm për veprimtarinë e inspektorateve shtetërore dhe të inspektojë dosjet e inspektimit, si dhe çdo dokument tjetër të lidhur me programimin e kryerjen e procedimeve administrative të inspektimit. Inspektorati Qendror nuk ndikon në zhvillimin e procedimit dhe vendimmarrjen përkatëse për një rast konkret.

5. Procedurat e hollësishme për ushtrimin e kompetencave të Inspektoratit Qendror, sipas këtij neni, dhe rregullat për përmbajtjen dhe administrimin e *portalit* unik të inspektimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17

Drejtimi dhe statusi i punonjësve të Inspektoratit Qendror

1. Inspektorati Qendror drejtohet nga Inspektori i Përgjithshëm, që emërohet dhe shkarkohet nga detyra nga Kryeministri.

2. Inspektori i Përgjithshëm drejton veprimtarinë e Inspektoratit Qendror dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.

3. Marrëdhëniet e punësimit të nëpunësve të Inspektoratit Qendror, me përjashtim të punonjësve të tjerë, që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në legjisllacionin për nëpunësit civilë për institucionet e pavarura, përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj. Inspektori i Përgjithshëm është “eprori i drejtpërdrejtë” i nëpunësve të inspektoratit, në kuptimin e këtyre dispozitave.

Seksioni 4

Mbikëqyrja dhe raportimi i inspektorateve

Neni 18

Marrëdhëniet e inspektorateve qendrore me ministrinë përgjegjëse

1. Ministria përgjegjëse mbështet funksionimin efektiv të inspektoratit shtetëror në varësi të saj. Kjo përgjegjësi nuk përfshin drejtimin operacional të veprimtarisë së inspektimit.

2. Ministria përgjegjëse, me mbështetjen metodologjike të Inspektoratit Qendror, përcakton:

a) objektivat vjetorë dhe afatmesëm strategjikë të inspektoratit shtetëror;

b) treguesit specifikë të efektivitetit e të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit dhe punës së inspektorateve shtetërore.

3. Inspektorati shtetëror i paraqet ministrit përgjegjës dhe Inspektoratit Qendror raportin vjetor të inspektimit.

4. Ministri përgjegjës ka të drejtë të kërkojë raporte, informacione dhe dokumente për menaxhimin institucional e financiar të institucionit dhe veprimtarinë e inspektimit në përgjithësi apo për një çështje konkrete.

5. Ministri mund të urdhërojë, me shkrim dhe në mënyrë të motivuar, fillimin e një inspektimi për një subjekt të caktuar apo për një çështje konkrete që përfshin më shumë se një subjekt.

Neni 19

Marrëdhëniet e inspektorateve vendore me njësinë e qeverisjes vendore

1. Organi ekzekutiv i njësisë së qeverisjes vendore mbështet funksionimin efektiv të inspektoratit vendor. Kjo përgjegjësi nuk përfshin drejtimin operacional të veprimtarisë së inspektimit.

2. Organi ekzekutiv i njësisë së qeverisjes vendore, me mbështetjen metodologjike të Inspektoratit Qendror, përcakton:

a) objektivat vjetorë dhe afatmesëm strategjikë të inspektoratit vendor;

b) treguesit specifikë të efektivitetit e të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit dhe punës së inspektorateve vendore.

3. Inspektorati vendor u paraqet organit ekzekutiv të njësisë së qeverisjes vendore dhe Inspektoratit Qendror raportin vjetor të inspektimit.

4. Organi ekzekutiv i njësisë së qeverisjes vendore ka të drejtë të kërkojë raporte, informacione dhe dokumente për menaxhimin institucional e financiar të institucionit dhe veprimtarinë e inspektimit në përgjithësi apo për një çështje konkrete.

5. Organi ekzekutiv i njësisë së qeverisjes vendore mund të urdhërojë, me shkrim dhe në mënyrë të motivuar, fillimin e një inspektimi për një subjekt të caktuar apo për një çështje konkrete që përfshin më shumë se një subjekt.

Seksioni 5

Statusi i inspektorit qendror dhe vendor

Neni 20

Marrëdhënie e punësimit të inspektorit

1. Marrëdhëniet e punësimit të inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin për nëpunësit civilë për institucionet e pavarura, përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj. Kryeinspektori i inspektoratit përkatës është “eprori i drejtpërdrejtë” i inspektorëve, në kuptimin e këtyre dispozitave.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe për nëpunësit e tjerë të inspektoratit shtetëror, që nuk janë inspektorë, me përjashtim të punonjësve që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, të cilët u nënshtrohen legjislacionit të punës dhe legjislacionit tjetër, me zbatim të përgjithshëm në administratën publike.

Neni 21

Kualifikimi dhe testimi i inspektorëve

1. Inspektorët shtetërorë dhe vendorë u nënshtrohen trajnimit të detyrueshëm dhe testimit profesional fillestar përpara konfirmimit në përfundim të periudhës së provës dhe testimit periodik. Testimi profesional fillestar dhe ai periodik bëhen në bazë të një provimi që organizohet nga Inspektorati Qendror.

2. Moskalimi i testimit fillestar deri në përfundim të periudhës së provës apo moskalimi në testimin periodik, për shkaqe që varen nga vetë inspektori, shkakton përkatësisht moskonfirmimin në fund të periudhës së provës apo largimin nga detyra. Vendimi për largimin nga detyra, në rast të moskalimit periodik, merret nga “eprori i drejtpërdrejtë” sipas procedurave për disiplinën në legjislacionin për nëpunësit civilë, që zbatohen me ndryshimet përkatëse.

3. Këshilli i Ministrave përcakton intervalet e testimit periodik, rregullat e hollësishme për procedurën e provimit dhe kriteret përkatëse të vlerësimit në këtë procedurë.

Neni 22

Kryerja e veprimeve të inspektimit nga inspektori në periudhë prove

1. Inspektori në periudhë prove mund të kryejë veprime inspektimi vetëm nën mbikëqyrjen e një inspektori që ka kaluar testimin fillestar.
2. Inspektori i testuar mbikëqyr veprimet e inspektorit në periudhë prove dhe nënshkruan çdo akt të tij. Nënshkrimi është kusht për vlefshmërinë e aktit.
3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për periudhën deri në testimin e parë periodik pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 23

Kufizimet gjatë ushtrimit të detyrës dhe ndalime në mbarim të funksionit

Përveç sa parashikohet nga ligji nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, inspektori i nënshtrimit edhe kufizimeve të parashikuara për zyrtarët e organit tatimor ose doganor, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, kufizime këto, që zbatohen me ndryshimet përkatëse, sipas juridiksionit të inspektoratit ku inspektori ushtron detyrën.

KREU IV

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIMIN DHE AUTORIZIMIN E INSPEKTIMIT

Neni 24

Inspektimi i programuar

1. Një inspektim konkret autorizohet, si rregull, në bazë të programit të inspektimit.
2. Programimi i inspektimit hartohet nga vetë inspektorati, bazuar në metodologjitë e vlerësimit të rrezikut dhe në detyrimin për inspektimin periodik në rastet e parashikuara nga ligji i posaçëm.
3. Programi i inspektimit të inspektoratit shtetëror miratohet nga ministri përgjegjës pas marrjes së mendimit këshillimor nga Inspektorati Qendror, ndërsa programi i inspektimit të inspektoratit vendor miratohet nga organi ekzekutiv i njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 25

Inspektimi jashtë programit

1. Përjashtimisht, një inspektim konkret mund të autorizohet jashtë programit të inspektimit në rastet kur:
 - a) subjekti i inspektimit, që detyrohet të paraqesë një informacion periodik, sipas ligjit të posaçëm, nuk e ka përmbushur këtë detyrim brenda afatit të caktuar, nuk e ka përmbushur në mënyrë të plotë, apo ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e informacionit të paraqitur;
 - b) nga monitorimi dhe mbikëqyrja e kryer nga inspektoratet, nëpërmjet analizës periodike dhe të vazhduar të të dhënave apo informacioneve, lind dyshimi i arsyeshëm për shkeljen e kërkesave ligjore dhe arrihet në përfundimin se është i nevojshëm fillimi i një inspektimi;
 - c) si pasojë e informacionit të marrë nga një institucion publik shqiptar apo një shtet tjetër a një organizatë ndërkombëtare, konsiderohet se është i nevojshëm fillimi i një inspektimi;
 - ç) ndodhja e ngjarjeve, aksidenteve apo incidenteve kanë cenuar apo mund të cenojnë jetën a shëndetin e njerëzve, kafshëve apo mjedisin;
 - d) parashikohet në pikën 5 të nenit 18 dhe në pikën 5 të nenit 19 të këtij ligji;
 - dh) parashikohet shprehimisht nga ligji i posaçëm.
2. Një inspektim, jashtë programit, mund të autorizohet edhe në bazë të një denoncimi apo informacioni të marrë nga të tretët, nëse krijohet dyshimi i arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore nga një subjekt.
3. Personi, që ka paraqitur denoncimin apo informacionin, sipas pikës 2 të këtij neni, informohet në përfundim të procedimit të inspektimit për rezultatet e tij, por nuk është palë e procedimit të inspektimit, në kuptimin e Kodit të Procedurave Administrative.

4. Inspektim jashtë programit konsiderohet edhe inspektimi në kushtet e flagrancës, sipas parashikimit të shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 27 të këtij ligji.

Neni 26

Kohëzgjatja vjetore e inspektimit në vendin e ushtrimit të veprimtarisë

1. Gjatë një viti kalendarik, një subjekt i caktuar inspektimi mund t’u nënshtrohet inspektimeve në vend, në fushën e veprimit të këtij ligji, për një periudhë kohore jo më të gjatë se periudha maksimale e lejuar e inspektimit vjetor.

2. Këshilli i Ministrave përcakton periudhën maksimale të lejuar të inspektimeve vjetore për kategori të ndryshme të subjekteve të inspektimit, në varësi të madhësisë së subjektit dhe rrezikut të veprimtarisë që kryhet, si dhe mënyrën e llogaritjes së saj. Periudha maksimale e lejuar e inspektimit vjetor është nga 5 deri në 15 ditë.

3. Në llogaritjen e periudhës maksimale të lejuar nuk përfshihet kohëzgjatja:

a) e inspektimit rastësor;

b) e inspektimit në rastin e ndodhjes së ngjarjeve, aksidenteve apo incidenteve që kanë cenuar apo mund të cenojnë jetën a shëndetin e njerëzve, kafshëve apo mjedisin, parashikuar në shkronjën “ç” të pikës 1 të nenit 25 të këtij ligji;

c) e inspektimit për verifikimin e korigjimit të shkeljeve në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 4 të nenit 48 të këtij ligji.

Neni 27

Autorizimi i një inspektimi

1. Procedimi administrativ i inspektimit fillon, si rregull, me lëshimin e autorizimit të inspektimit nga kryeinspektori, më poshtë “autorizimi”. Në rastin e inspektorateve shtetërore, të organizuara me degë territoriale, e drejta e autorizimit mund t’i delegohet drejtuesit të degës territoriale.

2. Inspektimi mund të fillojë pa autorizimin, sipas pikës 1 të këtij neni, vetëm kur:

a) konstatohet në flagrancë nga inspektori shkelja e një kërkesë ligjore, brenda fushës së tij të inspektimit;

b) inspektohet për rastin e ndodhjes së ngjarjeve, aksidenteve apo incidenteve, që kanë cenuar apo mund të cenojnë jetën a shëndetin e njerëzve, kafshëve apo mjedisin, parashikuar në shkronjën “ç” të pikës 1 të nenit 25 të këtij ligji;

c) inspektohet për rastet e parashikuara me ligjet e posaçme, që kryhen në pikat e kalimit kufitar;

ç) parashikohet shprehimisht nga ligji i posaçëm.

3. Fillimi i inspektimit në rastin e parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni pasqyrohet, pa vonesë, me një shënim në një rubrikë të posaçme të procesverbalit të inspektimit dhe konsiderohet, si autorizim i posaçëm. Inspektori detyrohet të njoftojë, pa vonesë, nëpunësin përgjegjës për lëshimin e autorizimit të inspektimit.

4. Autorizimi nuk mund të ankimohet veçmas vendimit përfundimtar të inspektimit. Lëshimi i autorizimit në kundërshtim me parashikimet e neneve 24 - 27 të këtij ligji, nuk përbën, veçmas, shkak për pavlefshmërinë e vendimit përfundimtar të inspektimit, por përbën shkelje disiplinore për nëpunësin përgjegjës që ka lëshuar autorizimin.

Neni 28

Përmbajtja e autorizimit

1. Në autorizimin e inspektimit përcaktohen, të paktën, këto elemente:

a) inspektorati shtetëror apo vendor përkatës, që lëshon autorizimin;

b) objekti i inspektimit;

c) baza ligjore;

ç) data dhe vendi i lëshimit;

d) identiteti i inspektorit apo i inspektorëve të autorizuar për të kryer inspektimin;

dh) identiteti i personave të tjerë të autorizuar për kryerjen e veprimeve ndihmëse, sipas pikës 1 të nenit 31 të këtij ligji;

e) emri apo emërtimi dhe adresa e subjektit të inspektimit, të dhëna për përcaktimin sa më të qartë të tij, në rastin e inspektimit rastësor, apo të dhëna për përcaktimin sa më të saktë të veprimtarisë konkrete që i nënshtrohet inspektimit, në rast se emri, emërtimi dhe adresa nuk janë të njohura;

ë) kohëzgjatja në ditë për kryerjen e inspektimit;

f) vendi apo vendet ku do të kryhet inspektimi;

g) të dhënat e identifikimit, pozicioni dhe nënshkrimi i personit që ka lëshuar autorizimin.

2. Inspektorët e një dege territoriale mund të kryejnë inspektime në kuadër të një dege tjetër territoriale vetëm me urdhër të posaçëm të kryeinspektorit.

3. Kur emri, emërtimi apo adresa e subjektit të inspektimit nuk janë të njohura apo në rastin e inspektimit rastësor, autorizimi përmban të dhëna të hollësishme, që lejojnë përcaktimin sa më të saktë të subjektit a të subjekteve të inspektimit.

4. Përmbajtja e hollësishme e autorizimit për çdo funksion inspektimi miratohet nga Inspektori i Përgjithshëm, me propozim të kryeinspektorit përkatës.

Neni 29

Kohëzgjatja e autorizimit

1. Autorizimi është i vlefshëm vetëm për kohëzgjatjen e përcaktuar shprehimisht në të.

2. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji i posaçëm, në raste përjashtimore, për shkak të kompleksitetit të veprimeve të inspektimit, kohëzgjatja mund të shtyhet me një herë të vetme dhe për një periudhë jo më të madhe se kohëzgjatja fillestare.

3. Shtyrja bëhet me propozim të inspektorit dhe me vendim të nëpunësit përgjegjës për lëshimin e autorizimit. Vendimi i njoftohet subjektit të inspektimit përpara skadimit të kohëzgjatjes dhe nuk mund të ankimohet veçmas.

4. Çdo veprim procedural i kryer jashtë kohëzgjatjes së përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni nuk prodhon asnjë pasojë juridike për subjektin e inspektimit dhe ngarkon me përgjegjësi disiplinore inspektorin përkatës.

5. Inspektimi që zgjat më pak se katër orë llogaritet si inspektim gjysmëditor, ndërsa ai që zgjat më shumë se katër orë, llogaritet si inspektim 1-ditor.

KREU V

PROCEDURA E INSPEKTIMIT

Seksioni 1

Personat pjesëmarrës në inspektim dhe njoftimi i inspektimit

Neni 30

Personat e autorizuar për të kryer veprime inspektimi

1. Inspektimi kryhet nga inspektorët e përcaktuar në autorizimin e inspektimit.

2. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji i posaçëm, vetëm inspektorët, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të kryejnë veprime inspektimi dhe gëzojnë të drejtat e parashikuara në këtë ligj.

3. Zëvendësimi i një inspektori të përcaktuar në autorizimin e inspektimit mund të bëhet vetëm me vendim të veçantë të nëpunësit përgjegjës për lëshimin e autorizimit, që i njoftohet pa vonesë subjektit të inspektimit dhe, sidoqoftë, përpara fillimit të veprimeve nga inspektori i ri.

4. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë inspektuese, inspektori identifikohet me kartën e inspektorit. Karta e inspektorit lëshohet nga Inspektorati Qendror, për inspektoratet shtetërore, apo nga organi ekzekutiv i qeverisjes vendore, për inspektoratet vendore.

Neni 31

Mbështetja e veprimeve të inspektimit

1. Inspektori, për përcaktimin e fakteve e të rrethanave të nevojshme për marrjen e një vendimi për inspektimin, mund të kërkojë ndihmë të specializuar nga nëpunës, organe publike apo ekspertë e subjekte të certifikuara private.

2. Gjatë inspektimit mund të kryhen, gjithashtu, veprime të caktuara ndihmëse edhe nga nëpunës të tjerë të organit inspektues që nuk janë inspektorë.

3. Personat e parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk kanë të drejtat e përcaktuara nga ky ligj për inspektorin dhe nuk mund të marrin vendime procedurale apo përfundimtare për inspektimin. Sidoqoftë, ata kanë detyrimin të mos përhapin a përdorin të dhënat personale dhe ato që lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale të subjektit të inspektimit a të personave të tjerë të përfshirë, që mbrohen sipas legjislacionit në fuqi dhe me të cilat njihen gjatë inspektimit.

Neni 32

Njoftimi i inspektimit

1. Inspektimi i njoftohet nëpërmjet njoftimit paraprak të autorizimit subjektit të inspektimit jo më vonë se 3 ditë përpara fillimit të veprimeve të inspektimit.

2. Njoftimi paraprak nuk kryhet në këto raste:

a) kur ekziston rreziku që njoftimi mund të pengojë kryerjen me efektivitet të inspektimit;

b) kur mosnjoftimi përcaktohet shprehimisht nga ligji i posaçëm;

c) për inspektimin për verifikimin e korigjimit të shkeljeve në përfundim të afatit të përcaktuar, sipas pikës 4 të nenit 48 të këtij ligji;

ç) për inspektimet e parashikuara në pikën 2 të nenit 26 të këtij ligji;

d) për inspektimin rastësor.

3. Mosnjoftimi paraprak i inspektimit, sipas shkronjës “a” të pikës 2 të këtij neni, vendoset nga personi që lëshon autorizimin dhe pasqyrohet në autorizim. Vendimi i mosnjoftimit paraprak motivohet.

4. Në rast të mosnjoftimit paraprak, inspektimi njoftohet njëkohësisht me fillimin e veprimeve të inspektimit, nëpërmjet:

a) dorëzimit të autorizimit, përfaqësuesit të subjektit të inspektimit, në rastet e parashikuara në shkronjat “a” - “c” të pikës 1 të këtij neni. Në rast të refuzimit të marrjes së autorizimit apo mosgjetyes së personit përfaqësues, inspektori e afishon autorizimin në vendin ku kryhet inspektimi dhe ky fakt pasqyrohet në procesverbal;

b) njoftimit me gojë në rastet e tjera.

5. Pavarësisht nga njoftimi paraprak, në çdo rast, inspektori, përpara fillimit të veprimeve të inspektimit, informon, verbalisht, përfaqësuesin e subjektit të inspektimit për objektin e inspektimit e për të drejtat dhe detyrimet e subjektit të inspektimit, sipas ligjit, si dhe për pasojat ligjore të mosrespektimit të këtyre detyrimeve.

Neni 33

Vendi i inspektimit

1. Vendi i inspektimit përcaktohet në autorizim. Vendi i inspektimit mund të jetë:

a) kudo ku kryen veprimtarinë e tij subjekti i inspektimit dhe ndodhen faktet që lidhen me respektimin apo mosrespektimin e kërkesave ligjore;

b) në zyrat e organit inspektues, nëse nga natyra e inspektimit është i mundur të kryhet inspektimi.

2. Në rastin e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, subjekti i inspektimit ftohet, nëpërmjet njoftimit paraprak, të paraqitet në zyrat e inspektoratit. Nëse është e nevojshme, inspektori mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve, të sendeve apo të të dhënave të tjera, të nevojshme për kryerjen e inspektimit në zyrat e tij.

Neni 34

Koha për kryerjen e inspektimit

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, veprimet e inspektimit zhvillohen në kohën më të përshtatshme për kryerjen me efektivitet të tyre, pavarësisht nga kohëzgjatja normale e punës së inspektorit apo subjektit të inspektimit.

2. Kur inspektimi në vend nuk mund të përfundojë pa ndërprerje dhe, nëse është e domosdoshme, inspektori mund të vendosë ndalimin e hyrjes në mjediset nën inspektim apo dyllosjen e makinerive, të pajisjeve e të dokumenteve të caktuara, për periudhën e ndërprerjes së veprimeve të inspektimit, deri në rifillimin normal të tyre, por jo për më shumë se 2 ditë.

3. Vendimi, sipas pikës 2 të këtij neni, pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit dhe i njoftohet me gojë përfaqësuesit të subjektit të inspektimit. Vendimi nuk mund të ankimohet veçmas.

Seksioni 2

Të drejtat dhe detyrimet e subjektit të inspektimit

Neni 35

Të drejtat e subjektit të inspektimit

1. Subjekti i inspektimit ka këto të drejta gjatë inspektimit:

- a) të kërkojë të njihet me autorizimin e inspektimit para fillimit të inspektimit, përveç rasteve kur, sipas ligjit, inspektimi nuk bëhet në bazë të autorizimit;
- b) të kërkojë identifikimin e inspektorëve nëpërmjet kartës së inspektorit;
- c) të jetë prezent dhe të ndjekë, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, të gjitha veprimet e inspektimit;
- ç) të kërkojë dhe të marrë informacion nga inspektori për procedurën e inspektimit dhe për çdo veprim apo vendim të ndërmarrë gjatë saj;
- d) të paraqesë, me shkrim apo me gojë, mendimet, shpjegimet për faktet, rrethanat apo edhe për çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me inspektimin, apo të paraqesë propozimet e tij për zgjidhjen e çështjes dhe dokumentet përkatëse ku i mbështet ato;
- dh) të kërkojë të njihet dhe t'i njoftohet procesverbali i inspektimit;
- e) të paraqesë kontestimet e tij për vlerësimin e provave të administruara, për rezultatet e hetimit dhe për vendimin që synohet të merret nga organi publik.

2. Kur pjesëmarrja, gjatë kryerjes së inspektimit, sipas shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, pengon kryerjen e veprimeve të inspektimit, inspektori mund të vendosë përjashtimin nga pjesëmarrja. Vendimi pasqyrohet në procesverbal dhe nuk mund të ankimohet veçmas.

Neni 36

Detyrimet e subjektit të inspektimit

Përveç sa parashikohet nga ligji i posaçëm, subjekti i inspektimit ka këto detyrime gjatë veprimtarisë së inspektimit:

- a) të caktojë një përfaqësues për të komunikuar me inspektorin gjatë inspektimit, në rast se nuk dëshiron të komunikojë drejtpërdrejt me inspektorin;
- b) të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e veprimeve të inspektimit. Mungesa e bashkëpunimit vlerësohet bashkë me provat e tjera;
- c) të ndalojë kryerjen e plotë apo të pjesshme të veprimtarisë, nëse kjo është domosdoshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së inspektimit dhe kur kërkohet nga inspektori me shkrim në procesverbalin e inspektimit;
- ç) të sigurojë një vend të përshtatshëm për punën e inspektorit, nëse inspektimi kryhet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë;
- d) të paraqesë çdo informacion, dokument dhe të japë çdo shpjegim për faktet e rrethanat e konstatuara dhe të nevojshme për inspektimin, nëse kërkohet nga inspektori dhe brenda afateve të përcaktuara nga ai;
- dh) të lejojë dhe të mundësojë marrjen e dëshmive nga punëmarrësit e tij, nëse kjo kërkohet nga inspektori.

Seksioni 3

Të drejtat dhe detyrat e inspektorit

Neni 37

E drejta e hyrjes dhe inspektimit në mjediset e veprimtarisë së subjektit të inspektuar

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, inspektori ka të drejtë të hyjë dhe të inspektojë godinat, mjediset, objektet, mjetet e transportit, ku apo nëpërmjet të cilave ushtron

veprimtarinë subjekti i inspektimit, si dhe të inspektojë instalimet, pajisjet, makineritë, produktet, sendet, substancat, përbërësit dhe çdo send tjetër të lidhur me veprimtarinë, objekt inspektimi.

2. Hyrja dhe inspektimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhen pa pasur nevojë për lejen e subjektit të inspektuar. Në rast pengimi, hyrja dhe inspektimi mund të kryhen forcërisht në praninë e një punonjësi të Policisë së Shtetit, sipas procedurës së parashikuar në ligjin përkatës. Shpenzimet e nevojshme për realizimin e hyrjes forcërisht i ngarkohen subjektit të inspektimit dhe përcaktohen në procesverbal apo në vendimin përfundimtar.

Neni 38

Marrja e mostrave

1. Nëse është e nevojshme për qëllimin e inspektimit, inspektorët kanë të drejtë të marrin, pa pagesë, mostra të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve dhe t'ia nënshtrojnë ato ekzaminimit apo analizave.

2. Mostrat merren në prani të përfaqësuesit të subjektit të inspektuar, përveç rasteve kur ai është përjashtuar, me vendim, nga të qenit i pranishëm gjatë inspektimit. Përpara zgjedhjes së mostrave, inspektori i shpjegon përfaqësuesit procedurën e marrjes së tyre.

3. Inspektori merr mostra në sasinë e nevojshme për kryerjen e ekzaminimit apo analizave dhe për të siguruar përsëritjen e tij, nëse është e nevojshme.

4. Marrja e mostrave pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit. Inspektori është i detyruar të njoftojë rezultatet e ekspertizës apo të ekzaminimit brenda 4 ditëve nga data e marrjes së rezultatit të tyre.

5. Shpenzimet për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave parapaguhën nga inspektorati. Këto shpenzime përballohen nga subjekti i inspektimit, vetëm nëse rezultati i ekzaminimit apo analizave provon shkeljen e kërkesave ligjore përkatëse. Shuma e shpenzimeve pasqyrohet në vendimin përfundimtar të inspektimit.

6. Ekzaminimi dhe analiza e mostrave bëhen nga subjektet e akredituara, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Procedura të hollësishme për marrjen dhe trajtimin e mostrave, sipas tipit të inspektimit, si dhe metodologjia e llogaritjes së shpenzimeve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Pikat 1-7 të këtij neni zbatohen, me ndryshimet përkatëse, edhe për kryerjen e ekspertizave të tjera të nevojshme për verifikimin e produkteve, pajisjeve, proceseve apo makinerive.

Neni 39

Marrja e kopjeve dhe sekuestrimi i dokumenteve

1. Gjatë inspektimit, inspektori ka të drejtë të kërkojë dhe të marrë kopje të dokumenteve të veprimtarisë, në përputhje me objektin e inspektimit. Kërkesa bëhet me gojë dhe pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit. Çdo kopje dokumenti, i marrë, nënshkruhet nga përfaqësuesi i subjektit të inspektuar.

2. Inspektori ka, gjithashtu, të drejtë të sekuestrojë dokumente që lidhen me objektin e inspektimit, me qëllim verifikimin e autenticitetit apo korrekhtësisë së informacionit. Vendimi i sekuestrimit të dokumenteve pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit dhe përmban përshkrimin e plotë të dokumenteve të sekuestruara.

3. Pikat 1 e 2 të këtij neni zbatohen edhe për dokumentet e ruajtura në trajtë elektronike, regjistrimet elektronike e audio-vizive apo të çdolloj teknologjie tjetër.

Neni 40

Parimi i këshillimit dhe informimit

1. Inspektori siguron këshillimin e subjekteve të interesuara për parandalimin dhe shmangien e shkeljes së kërkesave ligjore, në mënyrë të thjeshtë, të kuptueshme dhe pa pagesë.

2. Inspektori, gjithashtu, informon subjektin e inspektuar për të drejtat dhe detyrimet e tij në procedimin administrativ të inspektimit dhe për pasojat ligjore të veprimeve apo mosveprimeve të tij gjatë këtij procedimi.

Neni 41

Të drejta të tjera të inspektorit

Përveç sa parashikohet më sipër në këtë seksion, inspektori, brenda objektit dhe qëllimit të inspektimit, ka edhe këto të drejta:

a) të kryejë fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjediseve, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, mjediseve, objekteve, mjeteve të transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave, përbërësve dhe çdo sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit;

b) të inspektojë çdo dokument apo regjistrim të nevojshëm për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, përfshirë edhe ato të ruajtura, të krijuara apo të mbajtura në format elektronik, apo çdo teknikë tjetër;

c) të bëjë matjet e nevojshme për të verifikuar respektimin e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit;

ç) të kryejë verifikime të dokumenteve për identitetin e personave, kur kjo është e nevojshme, sipas objektit të inspektimit;

d) t'i kërkojë subjektit të inspektimit apo punëmarrësve të tij të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar inspektimin;

dh) të marrë pa pagesë dhe të përdorë për qëllimet e inspektimit çdo të dhënë për subjektin e inspektimit dhe veprimtarinë e tij, nga çdo institucion shtetëror që i disponon ato;

e) të administrojë çdo mjet tjetër prove, sipas Kodit të Procedurave Administrative, për përcaktimin e situatës faktike dhe rrethanave të nevojshme për marrjen e një vendimi përfundimtar.

Neni 42

Mbështetja e inspektimit nga Policia e Shtetit

Nëse inspektori ndesh apo mund të ndeshë rezistencë fizike, apo pengohet në kryerjen e detyrës së tij, ai mund të kërkojë ndihmën e organit të Policisë së Shtetit që ushtron juridiksionin në zonën përkatëse, sipas procedurës së parashikuar në ligjin përkatës.

Seksioni 4

Masat urgjente

Neni 43

Masat urgjente

1. Inspektori, gjatë inspektimit, ka të drejtë që, me vendim të ndërmjetëm, të marrë masa urgjente, kur:

a) për shkak të shkeljes së konstatuar të kërkesave ligjore mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i riparueshëm i interesit publik apo i palëve të treta, veçanërisht kur është e nevojshme për të shmangur një rrezik të menjëhershëm për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve a për mjedisin;

b) ka një dyshim të arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore, nga e cila mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i riparueshëm, i interesit publik apo palëve të treta dhe është e nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme dokumentare ose kryerja e ekzaminimeve apo analizave.

2. Masat urgjente janë:

a) ndërprerja e kryerjes së një veprimi, veprimtarie apo një pjese të saj;

b) ndalimi i funksionimit të një instalimi, makinerie apo pajisjeje;

c) bllokimi dhe ndalimi i hyrjes në mjediset e ushtrimit të veprimtarisë;

ç) bllokimi dhe marrja në administrim e kafshëve, bimëve, mallrave, makinerive, produkteve apo sendeve;

d) ndalimi i përkohshëm i hyrjes në territorin e vendit të kafshëve, bimëve, mallrave, makinerive, produkteve apo sendeve;

dh) urdhërimi i subjektit të inspektimit të njoftojë të tretët apo publikun për rreziqet e mundshme;

e) edhe çdo masë tjetër që vlerësohet e domosdoshme dhe proporcionale për të realizuar qëllimin e masës urgjente.

3. Në rastin e ndalimit të hyrjes në territorin e vendit, sipas shkronjave “ç” e “d” të pikës 2 të këtij neni, sendet depozitohen dhe ruhen sipas dispozitave të ligjit të posaçëm apo përkatësisht marrëveshjeve ndërkombëtare.

4. Nëse është e mundur, qëllimi për të marrë një masë urgjente i njoftohet, paraprakisht, në mënyrë verbale, përfaqësuesit të subjektit të inspektimit, duke i dhënë mundësinë për të paraqitur pa vonesë komentet dhe shpjegimet përkatëse.

5. Vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente pasqyrohet në procesverbal dhe i njoftohet subjektit, pa vonesë, në mënyrë verbale. Një akt i shkruar me të njëjtën përmbajtje njoftohet brenda 24 orëve.

6. Vendimi i ndërmjetëm përfundon automatikisht me kalimin e afatit të parashikuar në të dhe, kur nuk është përcaktuar një afat i tillë, me:

a) njoftimin e revokimit të tij;

b) njoftimin e përfundimit të procedimit apo njoftimin e vendimit përfundimtar, që nuk konstaton shkelje të kërkesave ligjore;

c) skadimin e afatit për njoftimin e vendimit përfundimtar të inspektimit pa një vendim të tillë;

ç) njoftimin e vendimit të zgjidhjes së ankimit ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit në rastin kur është bërë ankim;

d) skadimin e afatit për paraqitjen e ankimit administrativ ndaj vendimit përfundimtar pa bërë ankim;

dh) urdhërimin shprehimisht me vendim gjyqësor.

7. Vendimi i ndërmjetëm është me ekzekutim të menjëhershëm. Nëse nuk ekzekutohet vullnetarisht, pa vonesë, nga subjekti i inspektimit apo nëse ai bën të ditur ose nga rrethanat rezulton se nuk do ta ekzekutojë vendimin, vendimi ekzekutohet menjëherë nga inspektorati përkatës me shpenzimet e subjektit të inspektimit, të cilat pasqyrohen në vendimin përfundimtar apo në një akt të veçantë.

8. Masat urgjente mund të merren deri në çastin e marrjes së vendimit përfundimtar.

9. Kundër vendimit të masës urgjente, subjekti i interesuar ka të drejtën e ankimit të veçantë, sipas nenit 44 të këtij ligji.

Neni 44

Ankimi i veçantë

1. Ankimi i veçantë mund të paraqitet brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të ndërmjetëm dhe nuk pezullon ekzekutimin e tij.

2. Si rregull, ankimi i veçantë shqyrtohet drejtpërdrejt nga drejtuesi i degës territoriale. Nëse ligji i posaçëm parashikon që vendimi i ndërmjetëm të merret nga drejtuesi i degës territoriale apo një komision i posaçëm ose nëse inspektorati nuk ka degë territoriale, ankimi shqyrtohet drejtpërdrejt nga kryeinspektori.

3. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, ankimi i veçantë, në rastin e inspektimeve në juridiksionin e qeverisjes vendore, shqyrtohet drejtpërdrejt nga kryeinspektori vendor.

4. Vendimi për zgjidhjen e ankimit të veçantë merret dhe njoftohet brenda 6 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit.

5. Kundër vendimit për zgjidhjen e ankimit apo në rast se organi kompetent, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, nuk ka shqyrtuar ankimin në afatin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, mund të bëhet ankim në gjykatë sipas ligjit.

KREU VI

PROCESVERBALI I INSPEKTIMIT DHE VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Neni 45

Mbajtja dhe njoftimi i procesverbalit

1. Inspektori që kryen inspektimin mban procesverbalin e inspektimit, më poshtë “procesverbal”. Nëse veprimet e inspektimit i kanë kryer më shumë se një inspektor, në bazë të një

autorizimi të vetëm, ata e mbajnë procesverbalin së bashku. Procesverbali i inspektimit mbahet në tri kopje, të cilat nënshkruhen nga inspektori apo inspektorët që e kanë mbajtur.

2. Procesverbali, si rregull, mbahet në vendin e inspektimit dhe i njoftohet, pa vonesë, subjektit të inspektimit nëpërmjet dorëzimit personal. Nëse përfundimi i procesverbalit në vendin e inspektimit nuk është i mundur, ai përfundohet në zyrat e inspektoratit dhe njoftohet brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të inspektimit.

3. Procesverbali përmban informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe shoqërohet me listë-verifikimin e plotësuar gjatë inspektimit.

4. Procesverbali i inspektimit përmban, gjithashtu, informacion për të drejtën e subjektit të inspektimit që të paraqesë me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal, brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit, për paraqitjen e këtyre komenteve, si dhe organin ku paraqiten këto komente. Pas kalimit të këtij afati, vendimi përfundimtar mund të merret pa qenë i nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i subjektit të inspektimit. Shpjegimet apo kontestimet e subjektit të inspektimit janë pjesë e dosjes.

Neni 46

Shqyrtimi dhe marrja e vendimit përfundimtar

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga inspektori apo inspektorët që kanë kryer inspektimin, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të procesverbalit subjektit të inspektimit.

2. Nëse ligji i posaçëm parashikon që vendimi përfundimtar i inspektimit merret nga një njësi apo organ tjetër, atëherë procesverbali i hartuar sipas nenit 45 të këtij ligji i përcillet, pa vonesë, kësaj njësie a organi, së bashku me propozimin e inspektorit. Organi tjetër vendos brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Nëse ligji i posaçëm parashikon që inspektori duhet të shqyrtojë dhe të marrë një vendim përfundimtar, aty për aty, në përfundim të inspektimit, inspektori përpara marrjes së vendimit i shpjegon subjektit të inspektimit shkeljet e konstatuara, nëse ka të tilla, dhe vendimin që synon të marrë, duke dëgjuar shpjegimet apo kontestimet e tij, të cilat pasqyrohen në procesverbal. Vendimi përfundimtar pasqyrohet në procesverbal, i cili mbahet dhe njoftohet sipas pikave 1-3 të nenit 45 të këtij ligji. Shpjegimi dhe dëgjimi i subjektit nuk është i nevojshëm kur nuk konstatohen shkelje të kërkesave ligjore. Pika 4 e nenit 45 të këtij ligji nuk zbatohet në këtë rast.

Neni 47

Përfundimi i procedimit kur nuk konstatohen shkelje

1. Kur konstatohet se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore, procedimi administrativ i inspektimit përfundon me një vendim që pasqyrohet në fund të procesverbalit apo me vendim përfundimtar, pas shqyrtimit, sipas nenit 46 të këtij ligji.

2. Në vendimin e pasqyruar në procesverbal apo në vendimin përfundimtar përcaktohen edhe arsyet për përfundimin e procedimit.

3. Vendimi përfundimtar, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, i njoftohet subjektit të inspektimit.

Neni 48

Shkelja e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit

1. Kur konstatohet shkelje e kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që është e një rëndësie të vogël, apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ, subjekti i inspektimit dënohet me “paralajmërim”. Paralajmërimi është dënim administrativ kryesor.

2. Subjekti i inspektimit mund të dënohet drejtpërdrejt me një dënim tjetër kryesor administrativ, më të rëndë, të parashikuar në ligjin e posaçëm, kur:

a) nuk zbaton plotësisht dhe brenda afatit të përcaktuar urdhërimin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni;

- b) përsërit shkeljen e kërkesave ligjore;
- c) shkelja e konstatuar apo pasojat e saj janë të rënda.

3. Bashkë me dënimin kryesor mund të jepen edhe dënime plotësuese, sipas përcaktimit të ligjit të posaçëm. Për të njëjtën shkelje mund të vendoset një dënim kryesor dhe një apo më shumë dënime plotësuese.

4. Kur është e nevojshme, dënimi administrativ shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar dhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi i dënimin përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve që pasqyrohet në një fletë shoqëruese.

5. Në rastin e parashikuar në pikën 4 të këtij neni, subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe, nëse është e nevojshme, të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve mund të kryhet një inspektim i ri.

6. Moskorrigjimi i parregullsive brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 4 të këtij neni, përbën, veçmas, kundërvajtje administrative dhe dënimi kryesor mund të shoqërohet me dënimin plotësues, gjobë, në vlerë nga 10 000 deri në 100 000 lekë.

7. Këshilli i Ministrave miraton rregulloren e përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

8. Çdo inspektorat shtetëror apo vendor harton rregulloren e metodologjisë së përcaktimit të dënimeve, në fushën e tij të inspektimit. Rregullorja miratohet nga ministri përgjegjës për inspektoratet shtetërore dhe organi ekzekutiv i njësisë vendore për inspektoratet vendore.

Neni 49

Shkelje të dispozitave të tjera ligjore jashtë kompetencës së inspektorit

Kur inspektori, gjatë kryerjes së një inspektimi, ka dyshime të arsyeshme për shkeljen e kërkesave ligjore, që janë në kompetencën e një inspektorati tjetër shtetëror apo vendor, ai njofton me shkrim dhe pa vonesë Inspektoratin Qendror. Inspektorati Qendror, me marrjen e njoftimit, ia përcjell atë, pa vonesë, inspektoratit kompetent.

Neni 50

Njoftimi i të tretëve

1. Kur shkeljet e konstatuara gjatë inspektimit janë kryer në mënyrë të tillë që cenojnë të drejtat apo interesat e ligjshëm të një personi të tretë, inspektorati njofton personin e tretë për këtë fakt, gjetjet e inspektimit dhe masat e marra.

2. Nëse është e nevojshme, inspektorati mund të urdhërojë kryerjen e publikimit të vendimit përfundimtar apo një përmbledhje të tij.

Neni 51

Ankimi ndaj vendimit përfundimtar të inspektimit

1. Ankimi administrativ kundër vendimeve përfundimtare në fushën e inspektimit paraqitet dhe shqyrtohet sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm "Organi epror", sipas Kodit të Procedurave Administrative, është një njësi apo trupë kolegjiale ankimi, posaçërisht e krijuar brenda inspektoratit shtetëror, organit të varësisë, pjesë e të cilit është inspektorati shtetëror, apo njësisë vendore përkatëse dhe që ka në përbërje nëpunës të pavarur nga ata të përfshirë në marrjen e vendimit të ankimuar.

3. Organizimi i organit epror, sipas pikës 2 të këtij neni, për çdo inspektorat shtetëror përcaktohet nga Këshilli i Ministrave. Për inspektimet në juridiksionin e qeverisjes vendore, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, organizimi i organit epror përcaktohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

4. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji i posaçëm, paraqitja e ankimit administrativ pezullon ekzekutimin e vendimit përfundimtar të ankimuar, por nuk cenon ekzekutimin e masave urgjente të marra sipas nenit 43 të këtij ligji.

Neni 52

Konstatimi dhe shqyrtimi i kundërvajtjeve jashtë veprimtarisë normale të inspektimit

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, inspektorati shtetëror apo vendor është kompetent edhe për konstatimin e shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative në fushën e veprimtarisë së tij shtetërore, jashtë veprimtarisë normale të inspektimit, në kuptimin e këtij ligji.

2. Në rastin e parashikuar në pikën 1 të këtij neni zbatohen, me ndryshimet përkatëse, rregullat e përcaktuara në kreun VI të këtij ligji.

Neni 53

Plotësimi i dispozitave të ligjit për kundërvajtjet administrative

Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, dispozitat e këtij kreu plotësohen me dispozitat e ligjit për kundërvajtjet administrative.

**KREU VII
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE**

Neni 54

Kundërvajtjet administrative

Prishja e shenjave dalluese të ndalimit të veprimtarisë apo bllokimit të pajisjeve a instalimeve, si dhe çdo shenjë tjetër, të vendosura nga inspektorët, si dhe pengimi i inspektimit, nëse nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë në vlerën nga 10 000 deri në 100 000 lekë. Të drejtën e konstatimit dhe të shqyrtimit të kundërvajtjes e ka çdo inspektor i inspektoratit kompetent.

**KREU VIII
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 55

Dispozita kalimtare

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të paraqesë propozimet për ndryshimet në ligjet e posaçme, që rregullojnë funksionet e inspektimit në fushën e zbatimit të këtij ligji, sipas parimeve të përcaktuara në këtë ligj për organizimin e organeve me funksione inspektimi dhe procedurën e inspektimit.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore për riorganizimin e organeve me funksione inspektimi në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore, sipas parimeve të përcaktuara në këtë ligj.

3. Deri në riorganizimin e organeve, sipas pikës 2 të këtij neni, organet ekzistuese me funksione inspektimi vazhdojnë të funksionojnë sipas organizimit të tyre përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 56

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore të parashikuara në pikat 1 e 2 të nenit 11, pikën 3 të nenit 12, pikën 2 të nenit 15, pikën 5 të nenit 16, pikën 3 të nenit 21, pikën 2 të nenit 26, pikën 7 të nenit 38, pikën 7 të nenit 48 dhe pikën 3 të nenit 51 të këtij ligji.

2. Ngarkohen ministri përgjegjës dhe përkatësisht organi ekzekutiv i çdo njësie vendore të miratojnë rregulloret e parashikuara në pikën 8 të nenit 48 të këtij ligji.

Neni 57
Fillimi i efekteve

1. Krerët I deri III dhe kreu VIII i këtij ligji i shtrijnë efektet menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
2. Krerët IV deri VII i shtrijnë efektet duke filluar nga data 1.1.2012.

Neni 58
Hyrja në fuqi

Ky ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7035, datë 29.6.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Bamir Topi**

VENDIM
Nr.106, datë 23.6.2011

**PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE,
ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT PËR ZBATIMIN E VENDIMIT
TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NR. 24, DATË 9.6.2011**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit dhe në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.24, datë 9.6.2011,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratimin e propozimit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, bashkëlidhur, për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 9.6.2011 për ripërtëritjen e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese çdo tre vjet në një të tretën e anëtarësisë së saj.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.107, datë 23.6.2011

**PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZOTIT FATMIR HOXHA
ANËTAR I GJYKATËS KUSHTETUESE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 125 të Kushtetutës dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës, nr.6672, datë 6.9.2010,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Fatmir Hoxha anëtar i Gjykatës Kushtetuese, në vend të zotit Sokol Sadushi, të cilit i ka përfunduar mandati.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.108, datë 23.6.2011

**PËR EMËRIMIN E KRYETARIT TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ENTIT
RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE)**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e ekipit përzgjedhës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Sokol Ramadani emërohet Kryetar i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2010**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

- *Duke njohur* e vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të qytetarëve, të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë;

- *Duke vlerësuar* kontributin e saj në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit bankar;

- *Duke vlerësuar* rolin e kësaj agjencie për t'i siguruar Kuvendit, drejtuesve të institucioneve shtetërore dhe publikut në përgjithësi, një informacion cilësor e profesional mbi administrimin e depozitave të qytetarëve;

- *Duke mbështetur* e zhvilluar bashkëpunimin me këtë agjenci, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e saj me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

Vlerëson veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në drejtim të:

- Rritjes dhe konsolidimit të pozicionit të Agjencisë si institucion organizues, kontrollues dhe realizues i procesit të sigurimit dhe kompensimit të depozitave;

- Administrimit me efektivitet të mjeteve financiare të Agjencisë, nëpërmjet investimit të tyre në depozita pranë Bankës së Shqipërisë, letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare apo në letra me vlerë në monedhë të huaj të qeverive, bankave qendrore dhe institucioneve të tjera financiare ndërkombëtare, mbështetur në parimet e minimizimit të riskut të investimeve dhe likuiditetit të portofolit;

- Edukimit dhe informimit të publikut për çështjet e sigurimit të depozitave, me qëllim funksionimin në mënyrë efektive të sistemit;

- Vendosjes dhe thellimit të bashkëpunimit me organizmat dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, në tërheqjen e politikave më të mira apo ofrimin e asistencës teknike të nevojshme.

Kuvendi kërkon që Agjencia e Sigurimit të Depozitave për vitin 2011 të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Përmirësimin e politikave për sigurimin dhe kompensimin e depozitave, në zbatim të kuadrit ligjor në fushën e sigurimit të depozitave;

- Rritjen e bashkëpunimit me institucionet e specializuara, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës për realizimin e procesit të kompensimit të depozitave dhe në veçanti me Bankën e Shqipërisë, në drejtim të saktësisë së përlllogaritjes së primit dhe vlerësimit të gjendjes financiare të institucioneve bankare, të siguruar pranë Agjencisë.

- Edukimin dhe informimin e mëtejshëm të publikut për çështjet e sigurimit të depozitave;
- Përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor e nënligjor për të forcuar rolin e Agjencisë në krijimin e një sistemi sa më bashkëkohor të sigurimit të depozitave.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

23 qershor 2011

DEKRET
Nr.7028, datë 27.6.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 19 dhe 24 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U rijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre:

1. Albana Napolon Ramaliu (Cami)
2. Ylli Bilbil Shehu
3. Androniqi Koço Çikani (Hila)
4. Paskali Koço Qiriazhi (Hila)
5. Gulielmina Gjon Beni (Gjoni)
6. Toni Maksimilian Beni

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.471, datë 2.7.2011

PËR RRRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rritjen, në masën 4 për qind, të:

a) pensioneve të plota, të pjesshme dhe të parakohshme të pleqërisë, pensioneve të plota, të pjesshme dhe të reduktuara të invaliditetit, pagesave për sigurimin nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, pensioneve familjare, pensioneve për merita të veçanta dhe për vjetërsi shërbimi, të caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përjashtuar pensionet e caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

b) pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore, të caktuara me ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

c) shtesës mujore të përfiturar me vendimin nr.326, datë 21.6.1993 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar";

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994 të Presidentit të Republikës “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”;

d) shtesave mbi pension, të dhëna me nenin 33 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

dh) shtesave mbi pension, të dhëna me nenet 38, 39 dhe 48 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me nenin 24 të ligjit nr.4171, datë 13.6.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

e) pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensioneve suplementare të pleqërisë, pensioneve suplementare të invaliditetit, pensioneve suplementare të invaliditetit të ushtarakëve që, për shkak të detyrës, bëhen plotësisht të paafte për shërbim, pensioneve suplementare familjare, pensioneve suplementare familjare të ushtarakëve që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, të caktuara në përputhje me ligjin nr.10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakut të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”;

ë) trajtimeve të veçanta financiare të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara me ligjin nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit”, të ndryshuar, dhe trajtimit të veçantë financiar të pilotëve fluturues, sipas ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension”;

f) trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9361, datë 24.3.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundruar të nëndetësive dhe polumbarëve të forcave detare në pension”;

g) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të caktuara sipas ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar;

gj) trajtimeve të veçanta financiare, të caktuara sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”;

h) pensioneve suplementare, të caktuara sipas ligjit nr.10 139, datë 15.5.2009 “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë.”.

2. Rritjen, në masën 7 për qind, të:

a) pensioneve të plota dhe të pjesshme të pleqërisë, pensioneve të invaliditetit dhe pensioneve familjare, të caktuara në përputhje me ligjin nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

b) pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Rritjen sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi e përfitojnë edhe pensionet, të cilat caktohen nga data 1.7.2011 e në vazhdim, me kusht që data e fillimit të pensionit apo trajtimit të jetë deri më 30.6.2011, përfshirë edhe këtë datë.

4. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të këtij ligji, që kanë datë fillimi nga 1.7.2011 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 11 117 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë në muaj dhe më shumë se 22 234 (njëzet e dy mijë e dyqind e tridhjetë e katër) lekë në muaj.

5. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare, të caktuara në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi nga 1.7.2011 e në vazhdim, nuk caktohen më pak se 7 468 (shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë në muaj, por jo më shumë se 11 117 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë në muaj.

6. Përfituesit e pensioneve dhe të të ardhurave, të caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të caktuara në përputhje me ligjin

nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe me ligjin nr.10 142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakut të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë” me datë fillimi deri më 30.6.2011, përfshi edhe këtë datë, edhe pas rritjes së pensionit të caktuar, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, do të vazhdojnë të marrin kompensimin e çmimeve dhe kompensimin e të ardhurave mujore, sipas kriterëve dhe masës së përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 31.3.1994 “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, nr.471, datë 15.7.1996 “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, nr.401, datë 21.6.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr.763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, nr.415, datë 27.4.2009 “Për rritjen e pensioneve”, nr.477, datë 30.6.2010 “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr.17, datë 20.1.2007 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”.

7. Kompensimin e çmimeve sipas kriterëve dhe masës së përcaktuar në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 31.3.1994 “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, dhe nr.471, datë 15.7.1996 “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, do ta marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione me datë fillimi nga data 1.7.2011 e në vazhdim.

8. Kompensimet për të ardhura mujore minimale të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr.401, datë 21.6.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”, nr.763, datë 27.12.2006 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”, nr.415, datë 27.4.2009 “Për rritjen e pensioneve”, nr.477, datë 30.6.2010 “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr.17, datë 20.1.2007 “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”, do t’i marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione me datë fillimi 1.7.2011 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor plus kompensimin e të ardhurave të jetë:

a) deri në 12 767 (dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë në muaj për pensionet e pleqërisë dhe pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi;

b) deri në 12 267 (dymbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë në muaj për pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare;

c) deri në 8 158 (tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë në muaj, për pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe pensionet familjare të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. Pas datës 1.7.2011 të ardhurat minimale:

a) Të personave që përfitojnë pensionet e plota të pleqërisë dhe pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, përjashtuar ato të caktuara sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk mund të jenë më të ulëta se 13 267 (trembëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë në muaj.

b) Të personave që përfitojnë nga pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk mund të jenë më të ulëta se 8 358 (tetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekë në muaj dhe më të larta se 11 317 (njëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) lekë në muaj.

10. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 1 634 milionë lekë, përballohen nga fondi i kontigjencës i caktuar në Buxhetin e Shtetit të vitit 2011 dhe ndahen:

a) për mbulimin e pagesave të pensioneve në shumën 1 621 milionë lekë;

b) për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare sh.a., në shumën 13 milionë lekë.

11. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për të nxjerrë udhëzimet teknike dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.28, datë 23.6.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Piloçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datën 24.2.2011 mori në shqyrtim në seancë plenare çështjen nr.1 akti, që i përket:

KËRKUES: Kujtim Kryekurti, përfaqësuar nga avokat Skënder Demiraj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.00-2010-1233, datë 22.10.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Admir Thanza; përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës; dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi është akuzuar nga Prokuroria e Shkodrës për krimin e kontrabandës me mallra për të cilat paguhet akcizë sipas nenit 172 të Kodit Penal. Me vendimin nr.132, datë 25.4.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Shkodrës, i ka caktuar kërkuarit masën e sigurimit personal “arrest në burg” sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Këtë masë sigurimi kërkuari nuk e ka kundërshtuar dhe vendimi ka marrë formë të prerë.

2. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Shkodrës dhe i ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” me një masë më të lehtë. Me vendimin nr.219, datë 28.6.2010, kjo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij. Gjykata e Apelit të Shkodrës me vendimin nr.79, datë 30.7.2010 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.219, datë 28.6.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Shkodrës.

3. Kërkuesi ka paraqitur rekurs pranë Gjykatës së Lartë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2010-1233, datë 22.10.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit, me argumentimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

4. Kërkuesi në datën 17.11.2010 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr.00-2010-1233, datë 22.10.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për arsye se mosshqyrtimi i ankimit nga Gjykata e Lartë i ka mohuar të drejtën për t’u dëgjuar, si dhe për t’u ankuar pranë një gjykate kompetente. Sipas tij, në shqyrtimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit, Kolegji Penal (Dhoma e Këshillimit) nuk duhej të ishte mbështetur te neni 432 i KPP-së, por te neni 249 i KPP-së, i cili përcakton shqyrtimin e ankimit brenda 15 ditëve në seancë gjyqësore.

II

A. Për legjitimimin e kërkuesit

5. Për sa i përket legjitimitit të kërkuesit, në kushtet e dhënies së një vendimi të ndërmjetëm si ai i masës së sigurimit personal “arrest në burg”, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) çmon të bëjë disa vlerësime paraprake në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 30, pika 2 e ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, për sa i përket shterimit të të gjitha mjeteve juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përpara se individi t’i drejtohet Gjykatës.

6. Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shterur të gjitha mjetet juridike. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete (*shih vendimin nr.27, datë 20.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili, para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimin nr.1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Gjykata ka theksuar se neni 131/f i Kushtetutës ka të bëjë me faktin se kontrolli i ushtruar nga Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes të të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individi duhet t’i ketë shterur mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Juridiksioni kushtetues, për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt, bëhet i mundur kur kërkuesi të ketë shterur mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t’i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjete ligjore shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr.15, datë 18.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjykata vlerëson se Kushtetuta duhet interpretuar në atë mënyrë që të ketë kuptimin më të arsyeshëm dhe të frytshëm të mundshëm. Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Dhunimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeleve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e dhunimit të kësaj të drejte. Duke qenë se kërkuesi i ka shteruar mjetet e ankimit për “masën e arrestit në burg” dhe ankohet ndaj një vendimi të Gjykatës së Lartë, karakteri i këtij vendimi të ndërmjetëm e kërkon, si përjashtim, që ai të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 30/2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

9. Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), lidhur me zbatimin e nenit 6 të Konventës, për vendimet e ndërmjetme është shprehur: “Procedurat paraprake, të tilla si ato që kanë të bëjnë me vendosjen e një mase të ndërmjetme, si p.sh.: një urdhërim, normalisht nuk konsiderohen të jenë vendimtare për të drejtat dhe detyrimet civile dhe, si pasojë, normalisht nuk bien nën mbrojtjen e nenit 6 të Konventës (*shih Wiot kundër Francës, vendim i datës 15 mars 2001; APIS a.s. kundër Sllovakisë, vendim i datës 13 janar 2002; Libert kundër Belgjikës, vendim i datës 8 korrik 2004*). Megjithatë, në disa raste, GJEDNJ-ja ka zbatuar nenin 6 të Konventës për vendimet e ndërmjetme, sepse ato kanë qenë përfundimtare për sa u përket të drejtave civile të aplikuesit (*shih Aerts kundër Belgjikës vendim i datës 30 korrik 1998*). Për më tepër, është vlerësuar nga GJEDNJ-ja se një përjashtim duhet bërë nga parimi, se neni 6 i Konventës nuk aplikohet për vendime të ndërmjetme, kur natyra e vendimit të ndërmjetëm e kërkon këtë përjashtim (*shih Markass Car Hire Ltd kundër Qipros, vendim i datës 23 tetor 2001, Micallef vs. Malta, vendim i datës 15 tetor 2009*).

10. Për sa më lart, Gjykata çmoi se shqyrtimi i pretendimit, se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i ka mohuar kërkuesit të drejtën për t’u dëgjuar nga një gjykatë kompetente e caktuar me ligj është *ratione materiae* në juridiksionin e Gjykatës.

B. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar nga një gjykatë kompetente e caktuar me ligj, sipas standardeve të procesit të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës

11. Kërkuesi pretendon të drejtën për t'u dëgjuar nga një gjykatë kompetente. Sipas tij, në shqyrtimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit, Gjykata e Lartë (Dhoma e Këshillimit) nuk duhej të ishte mbështetur te neni 432 i KPP-së, por te neni 249 i KPP-së, i cili përcakton shqyrtimin e ankimit brenda 15 ditëve në seancë gjyqësore. Për rrjedhojë dhe procedura e ndjekur nga Dhoma e Këshillimit nuk është realizuar sipas standardeve të procesit të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës.

12. Gjykata vlerëson se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor mbi masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, konkretisht me lirinë e personit.

13. Në nenin 27 të Kushtetutës parashikohet se *“askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj”*. Ndërsa në nenin 28/1, parashikohet: *“Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet ... për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personi, të cilit i është hequr liria, duhet ... t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij”*.

14. E drejta e lirisë së individit dhe kufizimet e saj sanksionohen edhe në nenin 5/1, shkronja “c” të KEDNJ-së, sipas së cilës *çdokush ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj... kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent...*, si dhe paragrafi 4 ku parashikohet se: *“Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm”*.

15. GJEDNJ-ja ka theksuar se *“...Megjithëse nuk është e nevojshme gjithmonë që procedura sipas nenit 5/4 të KEDNJ-së të realizohet me të njëjtat garanci si ato të kërkuara sipas nenit 6 për çështje penale ose civile, duhet që kjo procedurë të ketë karakter gjyqësor dhe të sigurojë garancitë e duhura sipas llojit të privimit të lirisë. ... Për më shumë duhet të kemi në vëmendje se neni 5/4 dhe neni 6, pavarësisht lidhjes së tyre, kanë qëllime të ndryshme. Neni 5/4 ka si qëllim mbrojtjen kundër burgimit arbitrar, duke garantuar procedura të shpejta. Në rastet e paraburgimeve, sipas nenit 5/1 (c), shqyrtimi konsiston në faktin nëse ka apo jo një dyshim të arsyeshëm mbi të arrestuarin. Neni 6 merret me “përcaktimin e një vepre penale” dhe ka si qëllim të garantojë që faktet e çështjes, që përcaktojnë fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit, të shqyrtohen në një proces të drejtë dhe publik (*Reinprecht kundër Austrisë, vendim i datës 15 nëntor 2005*).*

16. GJEDNJ-ja është shprehur se *“...Në arsyetimin e vendimit të gjykatës për masat e sigurimit, duhet të analizohen në mënyrë ezauruese e reale motivet konkrete të pranimit ose jo të kërkesës/ankesës për revokim a zëvendësim të masës së sigurimit dhe jo të bëhet një përshtetësi ritual e formal i shkaqeve e kriterëve, të parashikuara nga ligji (*Sarban kundër Moldavisë, vendim i datës 4 tetor 2005*).*

17. Në vijim GJEDNJ-ja ka theksuar se *“ ... Neni 5/4 siguron një garanci thelbësore kundër arbitraritetit në burgim, duke kërkuar që një individ të cilit i është kufizuar liria, ka të drejtë të ketë një rishikim të ligjshmërisë së privimit. ... Një person i arrestuar dhe i privuar ka të drejtë që përballë gjykatave të tilla të shqyrtojë ligjshmërinë e burgosjes së tij, nën dritën jo vetëm të kërkesave ligjore kombëtare, por, gjithashtu, dhe të Konventës, parimeve të përgjithshme të shprehura në të dhe qëllimit të kufizimeve, të lejuara nga paragrafi 1 i nenit 5. Shqyrtimi gjithsesi duhet të jetë i gjerë mjaftueshëm mbi ato kriteret, të cilat janë thelbësore për një masë sigurimi me kufizim lirie” (*Hutchison Reid kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 20 shkurt 2003*).*

18. Gjykata vëren se KPP-ja, në titullin VI “Masat e sigurimit”, parashikon rregulla të hollësishme për masat e sigurimit personal. Nenet 228 e 229 parashikojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit. Në nenet 244 deri 249 parashikohen caktimi dhe zbatimi i masave të sigurimit, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të procedimit penal, përfshirë ankimin kundër vendosjes e zbatimit të tyre. Sipas nenit 249/1 të KPP-së mund të bëhet ankim kundër masave të sigurimit, ndërsa sipas nenit 249/8 të KPP mund të bëhet rekurs për shkelje të ligjit pranë Gjykatës së Lartë, për sa u përket masave të sigurimit. Sipas nenit 407/3 të KPP-së (*rastet dhe mjetet e ankimit*), mjetet e ankimit janë apeli, rekursi në Gjykatë të Lartë dhe kërkesa për rishikim. Ndërsa sipas nenit 433 të KPP-së, rekursi nuk pranohet nëse bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji.

19. Gjykata vlerëson se dispozitat e lartpërmendura janë të vetëlexueshme dhe, sipas tyre, individët mund t'i drejtohen Gjykatës së Lartë me rekurs edhe për masat e sigurimit në rast shkeljeje të ligjit. Sipas kësaj gjykate, neni 249/8 i KPP-së me termin ligjor “rekurs” ka përfshirë të gjithë procedurën e zakonshme ndjekur nga Gjykata e Lartë në të tilla raste.

20. Kërkuar ka kërkuar zëvendësim të masës së sigurimit “arrestit me burg” me një masë më të lehtë. Masa e sigurimit personal mund dhe duhet të ndryshohet duke u zëvendësuar me një më të lehtë ose më të rëndë, në varësi të ndryshimit të kushteve që ekzistojnë kur ajo u caktua. Kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose të dënimit që mund të caktohet, gjyqtari, me kërkesë të të pandehurit, e zëvendëson atë me një më të lehtë. Kolegji Penal (Dhoma e Këshillimit) pasi ka shqyrtuar rekursin për zëvendësim të masës së sigurimit personal “arrest në burg” me një masë më të lehtë, ka vendosur se shkaqet e parashtruara në rekursin e kërkuar nuk plotësojnë shkaqet e kërkuara nga neni 432 i KPP-së për ushtrim rekursi.

21. Gjykata për natyrën e gjykimit në Dhomë Këshillimi, ka vlerësuar se “...sikundër për pranimin ashtu edhe për mospranimin e rekursit, Dhoma e Këshillimit nëpërmjet arsytimit të vendimeve të saj luan rolin e një filtri paraeliminues të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë”. (...) e gjithë veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e të drejtës së palëve për t’iu drejtuar gjykatës, por është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj” (*shih vendimin nr.4, datë 25.02.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Dhoma e Këshillimit është e legjitimuar të veprojë pa pjesëmarrjen e palëve dhe të selektojë kërkesa për çështje themeli që kanë lidhje me fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit, para se t’i kalojë për shqyrtim në seancë gjyqësore. Gjykata vlerëson se kjo Dhoma aq më shumë duhet të jetë kompetente për shqyrtimin e ankimeve mbi ligjshmërinë e masave të sigurimit si veprime procedurale që nuk janë dënime penale dhe që nuk paragjykojnë pafajësinë dhe fajësinë e të pandehurit. Procedura e zhvilluar në Dhomë Këshillimi nuk ia heq karakterin gjyqësor shqyrtimit të çështjes.

23. Gjykata vlerëson se kompetenca e Gjykatës së Lartë në Dhomë Këshillimi për mospranimin e rekursit, jashtë shkaqeve të përcaktuara në nenin 432 të KPP-së pa pjesëmarrjen e palëve, e justifikon të njëjtën procedurë edhe në rast të zbatimit të nenit 249 të KPP-së për ankim ndaj masave të sigurimit. Gjithashtu, kjo Gjykatë çmon se mosrespektimi i afatit 15-ditor, të përcaktuar nga neni 249/10 i KPP-së për marrjen e vendimit nga Gjykata e Lartë në rast rekursi kundër masave të sigurimit, nuk passjell humbjen e fuqisë së masës së sigurimit, në dallim nga mosrespektimi i afatit 10-ditor për marrjen e vendimit në rast apelimi të masës së sigurimit në Gjykatën e Apelit, sipas nenit 249/5 të KPP, dhe kjo për arsye se neni 249/7 i KPP-së ka përcaktuar në mënyrë të shprehur vetëm efektet e mosrespektimit të afatit 10-ditor në rast mosshqyrtimi të apelit.

24. Si përfundim, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të kërkuar në lidhje me pretendimet e tij, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Petrit Pllloçi, Admir Thanza, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj

MENDIM PARALEL

Pavarësisht se në qëndrimin përfundimtar pajtohemi me vendimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, kemi mendim të ndryshëm për sa u takon shkaqeve për këtë qëndrim, pasi mendojmë se kërkesa duhej rrëzuar për shkak të mosshterimit të mjeteve për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

Neni 131/f i Kushtetutës parashikon se individë mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të pretendimeve të tij për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor vetëm pasi të ketë shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Gjykata ka theksuar se rregulli i vendosur nga dispozita e mësipërme kushtetuese e detyron kërkuesin që, për zgjidhjen e çështjes së tij, t'i drejtohet të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet: nr.17, datë 18.7.2005; nr.1, datë 25.1.2010 dhe nr.17, datë 16.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

Kërkuesi Kujtim Kryekurti është akuzuar për kryerjen e veprës penale të kontrabandës me mallra që paguhet akcizë, të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal. Ndaj kërkuesit gjykata ka caktuar si masë sigurimi personal atë të "arrest në burg", vendim i cili nuk është kundërshtuar në gjykatat më të larta, por ai i është drejtuar gjykatës për zëvendësimin e masës së dhënë me një tjetër më të lehtë, kërkesë, e cila është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Apelit Shkodër. Përfundimisht, në lidhje me këtë kërkesë, Gjykata e Lartë me vendimin nr.00-2010-1233, datë 22.10.2010 ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga kërkuesi, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP), vendim, i cili është bërë objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese.

Bazuar në nenin 228 të KPP-së, individë mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal vetëm në qoftë se në ngarkim të tij ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova. Masat e sigurimit personal vendosen kur plotësohen këto kushte: Ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që rrezikojnë marrjen ose vërtetësinë e provës; i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin po procedohet.

Prokurori, në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit personal, duhet të paraqesë shkaqet ku bazohet kërkesa, provat për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, provat që justifikojnë nevojat e sigurimit etj. Në çdo rast është gjykata që shqyrton nëse kërkesa e prokurorit është e bazuar, pra nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm se i gjykuari mund t'i shmanget gjykimit ose ekzekutimit të vendimit, apo nëse ka rrezik që ai të kryejë një vepër tjetër penale etj.

Bazuar në nenin 260/2 të KPP-së, kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë. Po ashtu, neni 260/3 parashikon edhe se kur nevojat e sigurimit rëndohen, gjykata, me kërkesën e prokurorit, zëvendëson masën e zbatuar me një tjetër më të rëndë.

Vendimi për zëvendësimin e masës së sigurimit personal, me një masë më të lehtë ose më të rëndë, konsiderohet një vendim i ndërmjetëm, pasi ai nuk vendos në mënyrë përfundimtare mbi objektin e kërkesës, që do të thotë se ai është një vendim i ndryshueshëm, pasi mund të ndryshohet ose revokohet sa herë që ndryshojnë rrethanat dhe kushtet në të cilat është dhënë. Me anë të ushtrimit të këtij mjeti procedural (i ndryshëm nga mjetet e ankimit: apel dhe rekurs), gjykata verifikon nëse ekzistojnë ende kushtet dhe kriteret që çuan në caktimin e një mase të caktuar sigurimi, nëse janë në fuqi të njëjtat nevoja sigurimi dhe nëse masa i përgjigjet ende rëndësisë së faktit etj.

Shumica argumenton në vendimin e saj: "*Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Dhunimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeleve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e dhunimit të kësaj të drejte. Duke qenë se kërkuesi i ka shteruar mjetet e ankimit për "masën e arrestit në burg" dhe ankohet ndaj një vendimi të Gjykatës së Lartë, karakteri i*

këtij vendimi të ndërmjetëm e kërkon, si përjashtim, që ai të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131/f të Kushtetutës....

Neni 27/2 i Kushtetutës parashikon se “Liria e personit nuk mund të kufizohet përveçse në rastet e mëposhtme: ... c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj”. Ky parashikim gjen pasqyrim edhe në dispozitën e nenit 228 të KPP-së. Pra, plotësimi i kriterit mbi dyshimin e arsyeshëm, që kërkon shkronja “c” e nenit 27/2 të Kushtetutës, lidhet me garancitë kushtetuese të individit për mosprivimin e lirisë. Në këto kushte, në vlerësimin tonë, është vendimi për caktimin e masës së sigurimit që konsiderohet si vendim përfundimtar në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, pasi ai vendos përfundimisht, në lidhje me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, bazuar në prova që justifikojnë privimin e lirisë së individit. Ndërkohë që rezulton, ndryshe nga sa parashtron shumica në vendimin e saj, se kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet e ankimit në lidhje me masën e arrestit, ky vendim ka marrë formë të prerë dhe ai i është drejtuar gjykatës për zëvendësimin e masës së sigurimit personal, vendim që është ankimuar edhe në gjykatat më të larta.

Ndonëse formalisht individi, që i drejtohet gjykatës për zëvendësimin e masës së sigurimit, pasi ka ezauruar edhe ankimin në apel dhe rekursin në Gjykatën e Lartë, nuk mund t’i drejtohet një gjykatë më të lartë, kjo nuk mund të interpretohet se ai ka shteruar mjetet juridike në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

Për sa më sipër, vlerësojmë se kërkuesi nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.

Anëtarë: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 5.7.2011
Doli nga shtypi më 5.7.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë